13 një sqarim, vetëm këto dy faqet, apo të gjitha faqet?

14 Z. HALLING: [Përkthim] I gjithë artikulli, të gjitha
15 faqet.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Faqet
18 përkatëse do t'i shtohen provës P01740, që është një provë
19 publike.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. HALLING: [Përkthim]

22 PY. Gjatë seancës përgatitore, a t'u dha mundësia të
23 rishikojë dhe të bëjë disa korrigjime të intervistave që keni
24 dhënë në vitin 1998, Dëshmitar?

25 PË. Po, e saktë.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran
2 materialin SPOE00230089 deri në 00230089 dhe në anglisht dhe
3 në shqip.

4 PY. Dëshmitar, a është kjo një nga intervistat e vitit 1998
5 që e lexuat edhe një herë gjatë seancës përgatitore?

6 PË. Po, kjo është.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do doja të shihnim në shqip
8 dhe në anglisht SPOE0023093 deri në 00230093.

9 PY. Dëshmitar, a është kjo një intervistë tjetër e vitit 1998
10 që e rishikuat gjatë seancës përgatitore?

11 PË. Po besoj që është e njëjta në ekran.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe një tjetër, SPOE00230134 deri
13 në 00230143 [Sipas përkthimit] në anglisht dhe në shqip -- 134
14 - më falni.

15 PY. Dëshmitar, po këtë intervistë e rishikuat edhe një herë
16 gjatë seancës përgatitore?

17 PË. Po, e saktë.

18 PY. Tani, këto tri intervistat e vitit 1998 që sapo pamë në
19 ekran, në atë kohë, përgjigjet mos jua kishte përgatitur
20 dikush tjetër?

21 PË. Në këtë kohë përgjegjës për informim edhe e kam sqaru që
22 ka qenë Shaban Shala. Edhe gjithashtu ka pas edhe pozitën në
23 zonë si pjesëtarë si edhe për media por edhe me komunikim me
24 qytetarët, domethënë marrëdhënie ushtarako-civile.

25 PY. Ju i lexonit përgjigjet e Shaban Shalës përpara se të

1 botoheshin; i shikonit njëherë?

2 PË. Faktikisht e kam pas besimin e plotë edhe ka qenë më i
3 përgatitun për media dhe për intervista. Unë shumë nuk jam
4 marrë me to. Shumicën e kohës e kam kalu në pozicione bashkë
5 me ushtarët e mi. Herë pas here jemi konsultu.

6 PY. Tani kur i rishikuat gjatë seancës përgatitore, a mund të
7 na thoni që përmbajtja e këtyre intervistave është e saktë, me
8 përjashtim të korrigjimeve që bëtë në seancën përgatitore dhe
9 që është hedh në shënimin përgatitor?

10 PË. Edhe në seancë edhe kur kemi bisedu rreth kësaj
11 interviste unë kam jep një sqarim që intervista është përgatit
12 me pyetje-përgjigje dhe është përgatit nga departamenti ose të
13 them -- Shaban Shala rreth përgjigjeve dhe unë e kam lëshu një
14 sy dhe e kam - aq të lëshohet kjo intervista. Dhe po ashtu ne
15 e kemi diskutu këtë çështje.

16 PY. E kuptoj këtë. Por po flasim për rishikimin e javës së
17 kaluar para se të vinit këtu për dëshminë tuaj. Tani mund të
18 na thoni që intervistat janë të sakta me përjashtim të
19 ndryshimeve që janë pasqyruar në shënimin përgatitor?

20 PË. Po, e saktë.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të përmendim dhe një herë
22 ndryshimet në mënyrë që të pasqyrohen në procesverbal. Do
23 lutesha t'i ktheheshim edhe një herë materialit SPOE00230093
24 dhe të vendosim këtë faqe në shqip dhe faqet 3 të PDF-së të
25 anglishtes.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

2 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, doja që
3 korrigjimet të pasqyroheshin në procesverbal.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 Z. HALLING: [Përkthim] SPOE00230093 është numri i saktë
6 në shqip dhe faqja 3 e transkriptit të anglishtes.
7 Faleminderit.

8 PY. Dëshmitar, këtu thuhet:

9 "Komandant Sulltani: Po. Në ushtrinë tonë të gjitha
10 strukturat organizative janë themeluar. Pra, sot UÇK-ja ka
11 formuar policinë ushtarake, gjykatën e lartë ushtarake,
12 burgjet ushtarake dhe me radhë, kështu me radhë."

13 Më pas thuhet:

14 "Të gjithë ata që janë në burg, janë të burgosur lufte."

15 Data është 31 korrik 1998. Kjo që keni thënë ju këtë, për
16 gjykata ushtarake, etj. etj. është e ekzagjeruar; është një
17 ekzagjerim?

18 PË. Po, e kam shpjeguar, është një ekzagjerim edhe është një
19 intervistë e cila është e parapërgatitur dhe është lëshu me
20 pëlqimin tim.

21 PY. E kuptova.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Tani shohim korrigjimin e dytë
23 SPOE00230134 është numri. Kjo është shqipja, ndërsa anglishtja
24 është faqja 2 e transkriptit të rishikuar në gjuhën angleze.

25 PY. Është një pyetje këtu. Thuhet:

1 "Çfarë mund të na thoni për hierarkinë e UÇK-së?"

2 Dhe ju jeni përgjigjur:

3 "UÇK-ja udhëhiqet nga Shtabi i Përgjithshëm dhe ka
4 hierarkinë në të gjitha nivelet që respektohet nga të gjitha
5 nivelet e strukturës ushtarake."

6 Dëshmitar, data është 13 gusht 1998. A mos është botuar
7 ky artikull gjatë ofensivës së përgjithshme serbe?

8 PË. Nuk e di saktë, por është kjo periudhë të cilën flitet.

9 PY. Kjo që ju keni thënë këtu për hierarkinë e UÇK-së në mes
10 të gushtit 1998, mos është po ashtu një ekzagjerim?

11 PË. Normal që është një ekzagjerim. Po Shtabi i Përgjithshëm
12 ka ekzistuar në formën të cilën mund ta shpjegoj edhe më vonë
13 edhe tashi çdoherë çfarë mundësish ka pas dhe cilat janë konë
14 përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre gjatë kësaj periudhe.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, bashkë me
16 korrigjimet që janë pasqyruar tashmë në procesverbal ne -- do
17 donim - më falni - të pranoreshin tri artikujt në fjalë.
18 Mendojmë që duhet të shtohet në provën P851 në mënyrë që të
19 dublikojmë provën ekzistuese, sepse kemi një version më të
20 pastër, më cilësor në gjuhën shqipe.

21 Pra, bëhet fjalë për materialin SPOE0023089 [Sipas
22 përkthimit] dhe kjo është një provë e re.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
24 kundërshtim?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kemi

1 kundërshtim për pranueshmërinë, por këto intervista nuk mund
2 të përdoren nga ZPS-ja për vërtetësinë e përmbajtjes, përveç
3 se në përjashtim me rregullën 154 dhe 153 -- 143. Kështu që
4 nëse ka ndonjë gjë konkretet në këto intervista që ZPS-ja
5 dëshiron t'i përdorë si bazë, atëherë e mira që pjesët
6 përkatëse t'i trajtojmë me dëshmitarin këtu në sallën e gjyqit
7 dhe në përputhje me rregullën 143.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk pajtohem me këtë. Megjithatë,
9 ky është një kundërshtim për pranueshmërinë. Ju për
10 pranueshmërinë nuk kishin asgjë kështu që nuk gjykojmë që do
11 ta shtojmë më tej këtë pjesë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk ka
13 kundërshtim për pranueshmërinë atëherë.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri do të jetë
15 P02030.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 [Përkthim] Materiali i radhës është SPOE0023093 deri në
18 002393 [Sipas përkthimit], pra, i njëjti numër. Dhe në
19 anglisht dhe në shqip, saktë?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
22 kundërshtime? Nuk shoh të ketë kundërshtime. Pranohet atëherë.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë
24 numrin P02031 dhe klasifikimi është publik.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Është edhe materiali i tretë

1 që thashë që lidhet me provën ekzistuese P851, mund t'ju jap
2 numrin nëse dëshironi.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, e kam
4 numrin, është SPOE00230134 deri në 00230134 në anglisht dhe në
5 shqip. Do t'i bashkëngjitur provës, kujt?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Po, duhet të bashkëngjitet me
7 provën 851.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull, atëherë. Ne
9 do t'i japim numrin P00851.1.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
11 vazhdoni.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i luteshim Sekretarisë të
13 nxirrte në ekran materialin si në vijim. Është prova materiale
14 P113. Ju lutem, vetëm faqen e parë që është me numër P008557.
15 PY. Dëshmitar, ky është një dokument tjetër që e keni lexuar
16 gjatë seancës përgatitore ku thuhet:

17 "... qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të mbajtur më
18 27 prill 1999, emëroi z. Sylejman Selimi që të ishte Komandant
19 i Gardës Kombëtare të Kosovës -- ky vendim hyn në fuqi
20 menjëherë, nënshkruar nga Kryeministri z. Hashim Thaçi."

21 Kjo që thuhet në këtë pjesë, që jeni emëruar si Komandant
22 i Gardës Kombëtare, a është informacion i saktë?

23 PË. Si informacion është i saktë, por nga emërimi...

24 Z. MISETIC: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Kundërshtoj
25 themelësinë. Kush është themelësia e kësaj?

1 Z. HALLING: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, u ndërpre përgjigja. Mund ta përfundoni, ju
3 lutem, se u ndërpre përgjigja në transkript?

4 Ju lutem, përfundojeni përgjigjen.

5 PË. Unë jam emëruar komandant garde, por nuk di nga kush
6 vendimi nga kush është lëshu. E kam sqaru edhe atëherë nuk e
7 di në këtë periudhë, a është lëshuar nga shefi i shtabit Agim
8 Çeku, apo nga ministri i mbrojtjes, apo -- por është --
9 atëherë ka qenë edhe Qeveria e Përkohshme në themelim e sipër.

10 PY. Kuptova. Në seancën përgatitore, a rishikove edhe
11 jetëshkrimin e Sylejman Selimit, që fillon në fund të së
12 njëjtës faqe -- biografinë?

13 PË. Mendoj.

14 PY. Biografia juaj, a është e saktë?

15 PË. Po.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Tani vendosim në ekran provën P186
17 në anglisht edhe në shqip vetëm faqen e parë.

18 PY. Dëshmitar, ky mendohet që është procesverbal i një takimi
19 në vitin 2001 në Prekaz ku keni qenë ju personalisht dhe
20 persona të tjerë. Ju e rishikuat këtë gjatë seancës
21 përgatitore. Ky dokument që po shohim ne a ka pasqyruar
22 saktësisht procesverbalin e takimit të 2001?

23 PË. Këtë ia kam shpjegu dhe juve që nuk e di a ka pas, nuk e
24 di s'më kujtohet a ka pas dikush që e ka mbajt procesverbalin
25 në atë kohë, por e di që e kemi pas takim dhe e pasqyron atë -

1 - njerëzit të cilët kemi qenë në takim.

2 PY. Në fakt e kisha diku tjetër. Ky procesverbal, a pasqyron
3 vërtet atë që është thënë në takim, a pasqyron tamam takimin
4 në vetvete?

5 PË. Takimi e -- sa më kujtohet mua, e thashë që ne kemi pas
6 një takim, por bisedat e të tjerëve nuk -- e di dhe nuk i
7 kujtoj, është kohë e gjatë dhe nuk e di, por këtë procesverbal
8 e kam pa dhe e kam jep atë mendimin tim që nuk e di që ka pas
9 procesverbal apo që është mbajt. Por është mbajt një takim i
10 tillë pas [E pakuptueshme].

11 PY. Ajo që është thënë nga pjesëmarrësit sipas këtij
12 procesverbali, a është e saktë; a është thënë vërtet nga ata
13 pjesëmarrës?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Kundërshtoj
15 për themelësinë.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po vetë dëshmitari ka qenë
17 pjesëmarrës në takim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

19 Dëshmitar, mund t'i përgjigjeni pyetjes.

20 DËSHMITARI: Nuk mund të flas vetëm për vete, por biseda e
21 të tjerëve nuk më kujtohet në këtë periudhë, se si ka vijuar
22 dhe kush çka ka thënë.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Tani mund të shohim Shënimin
24 Përgatitor 2 për të parë mos ka një mospërputhje. Na nevojitet
25 paragrafi 46 i materialit me numër 125424-125439.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. HALLING: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, në seancën përgatitore ju keni thënë kështu
4 për këtë gjë, "që keni marrë pjesë në takim dhe procesverbali
5 pasqyron saktësisht takimin. Dhe ajo që kanë thënë
6 pjesëmarrësit në këtë takim, sipas këtij procesverbali është e
7 saktë."

8 A është kështu?

9 PË. Unë thashë edhe një herë, ne e kemi diskutu dhe jemi
10 mundu me ta sqaru. Aq çfarë kam thënë unë mendoj që i përket
11 asaj çfarë kam thënë edhe procesverbali në shikim të parë unë
12 e kam pa që çfarë kanë thënë edhe të tjerët, por nuk jam i
13 sigurt -- a është vërtetësia e tyre. Edhe ta kam shpjegu edhe
14 ty edhe -- është që unë kam marrë pjesë në një takim dhe ky
15 takim ka ekzistuar. Te njerëzit -- procesverbalin e kam parë,
16 por kam thënë që nuk më kujtohet që ka pas dikush që ka mbajtur
17 procesverbal. Ashtu, mendoj që është e saktë kjo që ne e kemi
18 diskutu.

19 Por pasqyron një takim, kam thënë e prapë po them, që
20 pasqyron një takim i cili ka -- është mbajtur në Prekaz dhe nuk
21 e di bisedat e të tjerëve, nuk mujt me i mbajtur mend, ajo që
22 mundet me thënë është vetëm ajo që unë kam thënë.

23 PY. Gjatë seancës përgatitore kur e lexuat këtë, sipas asaj
24 që lexuat ju, a kishte ndonjë gjë të pasaktë apo ndonjë gjë që
25 s'ishte thënë nga pjesëmarrësit vërtet siç ishte pasqyruar në

1 procesverbal?

2 PË. Unë jam fokusuar vetëm atë që unë kam thënë dhe që unë
3 kam qenë në këtë takim. Por jo edhe bisedat e të tjerëve të
4 cilat janë pasqyru këtu.

5 PY. E kuptoj që ju fokusoheni tek ajo që keni thënë ju vetë.
6 Po pse gjatë seancës përgatitore ju thatë që edhe ajo që kanë
7 thënë pjesëmarrësit në këtë takim është e saktë?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Qerkini,
9 po.

10 Z. QERKINI: Z. Kryetar, nëse ka mundësi, Prokurori kur i
11 referohet notës përgatitore nuk e di a janë mundësitë teknike
12 që e njëjta të shfaqet në ekran, ngase nuk po e shohim që
13 është në ekran. Nëse ka mundësi.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Është e mundshme, por thjesht e
15 kemi në anglisht shënimin përgatitor, kështu që do duhet ta
16 merrni përkthimin nga përkthyesit me gojë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa faqe
18 është?

19 Z. HALLING: [Përkthim] 16 faqe. Domethënë, ideja është që
20 kur përgatitet shënimi përgatitor ia lexon një përkthyes
21 dëshmitarit në moment.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Qerkini.
23 Tani nuk e nxjerrin dot sepse janë 16 faqe në anglisht.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Megjithatë, me sa di unë, avokati
25 mund t'i shohë dokumentet në listën e materialeve dhe atje

1 është edhe dokumenti në fjalë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 [Përkthim] Z. Qerkini, e kuptoni, ju keni qasje në këtë

4 material. E keni dhe shënimin përgatitor në listën e

5 materialeve të Prokurorisë, tek *Legal Workflow* quhet sistemi.

6 Z. HALLING: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, ta përsëris edhe një herë pyetje?

8 PË. Po.

9 PY. E kuptoj unë që kur patë këtë procesverbal ju u fokusuat
10 tek ajo që kishit thënë ju vetë. Po a mund të na shpjegoni pse
11 gjatë seancës përgatitore ju thatë që ajo që kanë thënë
12 pjesëmarrësit në këtë takim është e saktë. Pse e thatë këtë
13 gjatë seancës përgatitore që është e saktë ajo që kanë thënë
14 pjesëmarrësit?

15 PË. Edhe një herë po them, po ta sqaroj dhe e kemi sqaruar
16 bashkërisht po më duket, por është një keqkuptim këtu. Unë kam
17 thënë që jam konë pjesëmarrës, atë çfarë kam thënë. Mirëpo
18 çfarë kanë thënë të tjerët nuk mund me i mbajt mend edhe nuk
19 mund me i kujtu. Kurse sa i përket për këtë unë i kam lexu
20 edhe të tjerëve, por jam fokusu vetëm në përgjigjet e mia, jo
21 të të tjerëve.

22 PY. Pasi e lexuat ju procesverbalin e këtij takimi dhe patë
23 çfarë kishin thënë të tjerët, a vërejtët aty ndonjë gjë që
24 ishte e pasaktë?

25 PË. Thashë dhe më herët që jam fokusu vetëm te, nuk e di sa

1 janë të sakta ose sa janë të pasakta për arsye se nuk i mbaj
2 mend edhe nuk i di diskutimet të cilat kanë qenë. Edhe sa janë
3 të sakta këtu të përshkruara. Unë kam them edhe po them edhe
4 tash, atë çfarë e kam thënë e kam -- edhe qëndroj pas, por
5 diskutimet e të tjerëve nuk i mbaj mend.

6 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, i kemi kërkuar
7 disa herë dëshmitarit të fokusohet te kjo pjesë e pyetjes, a
8 mund t'i kërkojmë Kryegjykatësit t'ia bëj këtë pyetje
9 dëshmitarit?

10 Z. DIXON: [Përkthim] E kundërshtoj. Dëshmitari mund të
11 përgjigjet si t'i kujtohet. Nëse z. Halling do patjetër të
12 diskutojë me dëshmitarin atë që është thënë nga pjesëmarrësit
13 e tjerë në takim, pavarësisht se ka kaluar shumë kohë, atëherë
14 le t'i marrë fjalë për fjalë të gjitha përgjigjet.

15 Por nuk mund të zgjedhë rrugën më të shkurtër që të
16 pranohet dokumenti dhe thotë, tani mund të vërtetohet
17 përmbajtja e këtij dokumenti. Le t'ia bëjë pyetjet një për një
18 në mënyrë sistematike.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt
20 dëshmitari nuk po i përgjigjet tërësisht pyetjes.

21 Dëshmitar, kur e lexuat ju këtë dokument, a kishte ndonjë
22 gjë në këtë dokument, në këtë dokument, me të cilin ju nuk
23 pajtoheshit, ju personalisht mund të thoni jo, s'ka qenë
24 kështu; kishte ndonjë gjë që ju e patë në këtë dokument që ju
25 ra në sy?

1 DËSHMITARI: I nderuar Gjykatës, unë e kam pa në tërësi
2 dokumentin; unë thashë edhe Prokurorit në bisedë e sipër që ne
3 -- unë jam fokusu vetëm në çfarë unë kam thënë dhe kam thënë,
4 po që ka qenë i.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prapë nuk po
6 i përgjigjeni. Kur e lexuat dokumentin, a kishte ndonjë gjë në
7 dokument me të cilën ju nuk pajtoheshit, nuk ka rëndësi kush e
8 ka thënë, po kishte ndonjë gjë me të cilën ju nuk pajtoheshit?

9 DËSHMITARI: Jo, nuk mund ta them një gjë të tillë që jam
10 pajtu as nuk jam pajtu me diçka të tillë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Që ta sqarojmë dhe
13 avokatin që ndërhyri. Kjo është një provë që është pranuar
14 tashmë dhe mund të hiqet nga ekrani. Provë e pranuar, provë
15 gjyqësore.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
17 mirë. Tani do bëjmë 15 minuta pushim dhe do rikthehemi, do
18 bëjmë -- do vazhdojmë deri në orën 13.00, pastaj do bëjmë
19 pushimin e drekës.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
22 deri në orën 11.45.

23 --- Seanca ndërpritet në orën 11.29

24 --- Seanca rifillon në orën 11.45

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

1 silleni Dëshmitarin në sallë, znj. Asistente.

2 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I nderuar z.
3 Kryegjykatës, dëshiroj që të ngre një çështje, nëse më lejoni.
4 Pa praninë e dëshmitarit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
7 Përshëndetje, më dëgjoni?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
9 vazhdoni.

10 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Dëshiroj që
11 të bëj një plotësim sa i takon kundërshtimit që bëra pak më
12 herët. Përsëri, Prokuroria tani ka kërkuar që të pranohen në
13 prova gjyqësore shumë intervista publike që ka thënë
14 dëshmitari. Qëndrimi ynë është që këto intervista nuk mund të
15 marrin të njëjtën peshë si dëshmia që do të japë Dëshmitari në
16 sallën e gjyqit. Trupi Gjykses ka vendosur më herët që parimi
17 i dëshmisë me gojë, pra, është baza e regjimit të të gjithë
18 sistemit të Dhomave të Specializuara. Kështu që edhe një herë
19 dëshirojmë që të themi që ne nuk pajtohemi me faktin që
20 intervistat e dëshmitarit të dhëna në përpara nuk mund të kenë
21 të njëjtën peshë si dëshmia që do të japë në sallën e gjyqit
22 dëshmitari.

23 Kështu që për këtë arsye ne do kërkonim që Prokurori t'i
24 bëjë pyetje në qoftë se dëshiron që të marrë informacion. Pra,
25 me fjalë të tjera, në qoftë se ka diçka në dëshmitë ose në

1 intervistat në të cilat Prokuroria synon që të mbështetet në
2 të ardhmen, ne besojmë që nuk është e drejtë për Mbrojtjen që
3 të mos jepet mundësia që të bëjmë pyetje lidhur me
4 informacionin që kanë këto intervista. Domethënë, me fjalë të
5 tjera, Prokuroria duhet ta nxjerrë viva voce këtë informacion
6 nga dëshmitari.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Halling.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Pesha që do t'i japi këtij
9 dokumenti varet nga Trupi Gjykses, dhe besoj që kjo është
10 diçka të cilën Trupi Gjykses do ta bëjë më vonë. Megjithatë,
11 tani për momentin ne mund të parashtrojmë që këto janë
12 dokumente të cilat dëshmitari nën betim ka thënë që janë
13 dëshmitë e tij.

14 Sa i takon këtyre dokumenteve, këto dokumente ne i kemi
15 dërguar përmes mocioneve të dhëna drejtpërsëdrejti në të
16 shkuarën. Megjithatë, mendoj që pozicioni është absolutisht i
17 qartë tani, në veçanti është i qartë sa i takon deklaratave që
18 kemi kërkuar për praninë sipas rregullës 154 që këto janë
19 intervista të cilat japin hollësi plotësuese.

20 Në qoftë se ju nuk na kërkon diçka tjetër, mendoj që
21 është me vend që të vazhdohet më tej.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po ju
23 kërkojmë gjë tjetër.

24 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Më lejoni
25 dhe diçka tjetër për procesverbal, të nderuar Gjykatës. Kjo që

1 i kërkohet Prokurorisë nuk është në pajtim me rregullën 154.
2 Domethënë, në qoftë se dëshmitarit i kërkohet që "thjesht
3 konfirmoni në qoftë se çfarë keni dhënë në intervistë është e
4 saktë", kjo në vetvete nuk do të thotë që jemi në kushtet e
5 përputhshmërisë në rregullën 154.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Më lejoni të them diçka ndërkohë
7 që nuk ka ardhur dëshmitari.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
9 vazhdoni.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Në faqen shtesë ne e kemi nxjerrë
11 në fakt këtë dokument përpara se sa të bënim pushimin. Me
12 fjalë të tjera është dokument që kërkuam që të pranohet në
13 provë, që është IT-05-87 6D00067, është faqja 32 -ET, është
14 një faqe e re dhe kërkojmë që kjo të lidhet ose t'i
15 bashkëlidhet provës P1745.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
17 kundërshtim? Përderisa nuk ka kundërshtim, dokumenti IT-05-87
18 6D00067, faqja 32 pranohet në prova gjyqësore. Ju lutem
19 bashkëlidheni tek prova ekzistuese P1745.

20 Mund të vazhdoni.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i shtohet kësaj
22 prove, të nderuar Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

1 z. Selimi tani do të vazhdojmë më tej me pyetjet e
2 Prokurorisë.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
4 PY. Dëshmitar, në dëshminë tuaj ju keni folur lidhur me
5 nofkën që keni pasur gjatë luftës, dhe e keni thënë që nofka
6 juaj ka qenë "Sulltani". A është e saktë kjo, Dëshmitar?
7 PË. Po, e saktë.

8 PY. A keni pasur ndonjë shenjë thirrëse, Dëshmitar, gjatë
9 luftës?

10 PË. Po, shifrën e kam pas 101.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Në këtë aspekt, do i kërkoja
12 Sekretares së seancës të paraqesë në ekran provën P1427, që
13 është një dokument prej një faqeje.

14 PY. Dëshmitar, këtë dokument nuk jua kemi treguar gjatë
15 seancës përgatitore, megjithatë do ta shikoni për një çast në
16 ekran. Sa për kontekst duhet t'ju them që informacioni në këtë
17 dokument në fakt konstaton që kjo është një listë e cila është
18 gjetur në shtëpinë e Rexhep Selimit. Presim një çast derisa të
19 paraqitet faqja në ekran.

20 Atëherë, besoj që e shikoni këtë faqe që është Çeliku 10,
21 101, e të tjera, te kolona e parë dhe pastaj te kolona e dytë
22 është "Tel" dhe te kolona e tretë është "Faks", domethënë që
23 mendoj që janë numrat e telefonit dhe të faksit. A mund të na
24 thoni, Dëshmitar, që këto numri që keni tek 101, tek shenja
25 thirrëse, ose tek shifra juaj, a është numër i telefonit që

1 keni pasur tek kolona e dytë e telefonit, është numër i saktë
2 ky?

3 PË. Nuk e di që është ky numër. A është -- nuk e mbaj mend
4 çfarë numri kam pas në atë kohë.

5 PY. A keni ndonjë arsye për të na thënë që këto nuk janë
6 numrat tuaja të telefonit? Domethënë, këto numra që janë
7 gjetur në listën e Rexhep Selimit, keni arsye për t'i
8 kontestuar, ose për t'i kundërshtuar se nuk janë numra tuaja?

9 PË. Po, kam arsye. E para është që 63 asnjëherë nuk kam pa
10 numër, e kam pas një telefon satelitor të cilin e kam përdor,
11 edhe nuk e di numri i saktë i cili, çfarë numri ka pas. Por
12 numër 63 nuk e di ndonjëherë që unë kam pas. Edhe se që e kam
13 përdor.

14 PY. Po sa i takon dy numrave të tjerë të telefonit, domethënë
15 për numrin e parë dhe numrin e dytë, a keni ndonjë arsye për
16 të kundërshtuar që këto nuk janë numrat tuaja për të
17 kontestuar faktin që këto kanë qenë numrat tuaja, Dëshmitar?

18 PË. Thashë edhe më herët, nuk e di numrin të cilin në atë
19 kohë e kam pas që e kam përdor në telefonin satelitor.

20 PY. E kuptoj. A është e saktë që sa i takon numrit të tretë,
21 ju nuk mendoni që është numër i saktë ky, por sa i takon
22 numrit të parë dhe të dytë, nuk keni të njëjtat arsye për të
23 kontestuar ose për të kundërshtuar numrat tuaja dhe për të
24 thënë që këto nuk janë numrat tuaja?

25 Z. DIXON: [Përkthim] Këtë pyetje ia bëri Prokurori

1 përpara dëshmitarit dhe e mori përgjigjen.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
3 kundërshtimi.

4 Z. HALLING: [Përkthim]

5 PY. Dëshironi që t'jua përmend dhe një herë, t'jua them dhe
6 një herë pyetjen, Dëshmitar.

7 PË. Jo, s'ka nevojë, por po ta shpjegoj që nuk e di çfarë
8 numri, unë e di që një telefon satelitor e kam përdor, jo dy
9 numra të telefonit satelitor, dhe ai numër nuk e di cili
10 është. Dhe nuk e mbaj mend çfarë numri ka pas.

11 PY. Në rregull.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta hiqni listën nga ekrani,
13 Sekretare.

14 PY. Tani, të kalojmë në periudhën përpara luftës, në
15 parapritë të luftës. Të fillojmë në vitin 1997. A keni marrë
16 pjesë ju në një sulm të bashkërenduar në stacione policie në
17 vitin 1997, Dëshmitar?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Kush jua ka caktuar ju detyrat për atë sulm, Dëshmitar?

20 PË. Adem Jashari, komandanti legjendar, Adem Jashari.

21 PY. Cilat ishin detyrat tuaja, çfarë ju kërkoi ai që të bënit
22 ju?

23 PË. Prej 1991, e kam shpjegu edhe ju edhe, që unë kam qenë
24 pjesë e grupit të Adem Jasharit dhe çdo gjë që ka pas nevojë
25 dhe që kam pas mundësinë kam qenë në mbështetje të tij.

1 PY. Çfarë ju kërkuan ju që të bënit, domethënë, me fjalë të
2 tjera çfarë detyrash ju caktuan juve për sa i takon këtij
3 sulmi të bashkërenduar te stacionet e policisë, Dëshmitar?

4 PË. Që unë të jem bashkë me ta në këtë sulm.

5 PY. Ku ka qenë pjesa juaj e sulmit, Dëshmitar?

6 PË. Unë e di që bashkërisht në një rast ne kemi qenë bashkë
7 me Adem Jasharin edhe me disa të tjerë.

8 PY. Ju thatë që keni shku bashkërisht. Ku keni shkuar, mund
9 të na e thoni?

10 PË. Po, unë e kam shpjegu edhe juve që kemi marrë pjesë në
11 stacionin, sulmin e stacionit të policisë në Runik.

12 PY. Çfarë sinjali u dha përmes këtij sulmi të UÇK-së?

13 PË. Që UÇK-ja ekziston, që UÇK-ja është.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tani të
15 paraqesë në ekran provën P279, në të dyja versionet, në
16 anglisht dhe në shqip. Të presim për një çast që të paraqitet
17 dhe versionin në anglisht në ekran, Dëshmitar.

18 PY. Dëshmitar, kjo është komunikata numër 36 e UÇK-së. Fillon
19 si më poshtë:

20 "Më 11 dhe 12 shtator 1997, me vendim të Shtabit të
21 Përgjithshëm, njësitet e armatosura të UÇK-së kryen një
22 operacion të sinkronizuar në të gjithë zonën operative 1."

23 Dhe këtu thuhet që:

24 "Është bërë një sulm në stacionin e policisë", dhe jepet
25 këtu dhe një listë vendesh, përfshirë këtu dhe Runikun.

1 A përfshin, a bëhet fjalë këtu për Runikun, sulmet e të
2 cilave sapo na i përmende pak më përpara, Dëshmitar?

3 PË. Besoj që po.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta hiqni nga ekranin.

5 PY. Tani, kalojmë tek sulmi në Rezallë të Re, që e keni
6 diskutuar në seancën përgatitore dhe gjithashtu edhe në
7 intervistën e dhënë për Zërin. Kjo betejë, a ka ndodhur diku
8 rreth vitit 1997, Dëshmitar?

9 PË. Po, e saktë.

10 PY. Po Ludovica, a është një tjetër emër që përmendet për
11 Rezallën e Re?

12 PË. Është i njëjti vend.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretares të
14 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00131751, deri në 00131878
15 [Sipas përkthimit]. Dhe faqja konkrete që dëshiroj të
16 paraqitet në ekran është SPOE00131840. Fillimi i dokumentit të
17 përkthyer në anglisht fillon tek SPOE00131824, nëse do e
18 ndihmoja Sekretaren me këtë. Në secilën prej këtyre -- e
19 njëjta faqe në secilin prej dokumenteve. Edhe një herë është
20 dokumenti SPOE00131840. Faleminderit.

21 PY. Dëshmitar, kjo është një intervistë e dhënë nga Rexhep
22 Selimi. Rexhep Selimi thotë si më poshtë sa i takon betejës në
23 Ludovicë. Atëherë, ai thotë:

24 "Në atë kohë thuhet që janë sjellë edhe armët përkatëse
25 që ishin vendosur në Llaushë, vendosur në një vendim të bërë

1 nga Azem Syla dhe shokëve të tjerë.”

2 Pyetje:

3 “Po ky mitralozi a u përdor edhe në betejën e Ludiviqit?

4 “Jo, këtë armë nuk e kishim akoma në betejën e Ludoviqit.

5 Atje kemi pasur mortaja dore, një mitraloz m-53 dhe të tjerat
6 kanë qenë snajpera dhe armë automatike. Madje, madje, në sajë
7 të armatimit ne nuk do të mund të godisnim aq shumë Serbinë as
8 sa e goditëm në sajë të strategjisë sonë dhe befasisë sonë.”

9 Përshkrimi që ka dhënë Rexhep Selimi, lidhur me armët e
10 përdorura nga UÇK-ja në këtë betejë, në betejën e Rezallës së
11 Re, a është i saktë, Dëshmitar?

12 PË. Ne kemi përdor gjithë ato arsenalin që ne kemi pasur,
13 kryesisht janë armatim i lehtë.

14 PY. E kuptoj këtë, Dëshmitar. Pyetja ime është kjo: Kjo që ka
15 përshkruar Rexhep Selimi, domethënë këto armët që ka
16 përshkruar Rexhep Selimi që ju keni pasur në dispozicionin
17 tuaj, a janë vërtet këto armë që keni përdorur atëherë? Kjo
18 është pyetja.

19 PË. Besoj që po. Nuk e di a i kemi pas në dispozicion. E shoh
20 këtë M-53 ose mitraloz 12.7. Nuk e kemi përdor ne në Rezallë
21 të Re, por armatim tjetër, të gjithë i kemi përdorur.

22 PY. Nga ana e tyre, Serbia a ka përdorur automjete të
23 blinduara dhe a ka përdorur dhe helikopterë në këtë betejë?

24 PË. Po, i ka përdor edhe mjetet e blinduara, ka përdor edhe
25 helikopterë.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretares të
2 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00227515 deri në 00227511 në
3 të dyja versionet, në anglisht dhe në shqip. Të shohim faqen e
4 dytë më konkretisht. Ju kërkoj ndjesë. Për të qenë i qartë në
5 versionin në shqip është faqja e parë, por në versionin e
6 përkthyer në anglisht është faqja e dytë.

7 PY. Atëherë, Dëshmitar, kjo është një intervistë me Musë
8 Jasharin, të cilën ju e keni parë në seancën përgatitore. A
9 është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Po, është e vërtetë.

11 PY. Ai thotë si më poshtë, sa i takon betejës në Rezallë të
12 Re:

13 "Adem Jashari e drejtoi luftën. Sylejman Selimi që ishte
14 i lënduar më herët ishte bashkë me ne. I kërkuam Sylejmanit që
15 të mos vinte me ne, për shkak të kushteve shëndetësore.
16 Megjithatë ai nuk na dëgjoi dhe erdhi gjithsesi.

17 "Ne po flasim lidhur me ditën pas sulmit në Vojnik më 26
18 nëntor ku janë organizuar vijat e para të frontit të UÇK-së.

19 "Atë ditë ne jemi përgatitur për sulmin. Jemi ndarë në
20 disa grupe në të dyja anët. Ne kemi, ky ishte beteja e parë
21 frontale me armikun. Kemi pritur për disa orë. Dëgjuam
22 gjithashtu zërin e Mujë Krasniqit kur na informoi që kishim
23 nevojë që të bëheshim gati kur autokolona serbe po vinte.
24 Ishte një veprim shumë i fuqishëm, mund të them që ka qenë një
25 përvojë me shokët tanë, me personat të cilët kanë qenë

1 kryesorët për grupin, dhe ka qenë një ditë shumë e suksesshme
2 për ne. Ndërkohë policia serbe vuajti shumë humbje në
3 personel, në pajisje gjithashtu. Dhe përderisa ata humbën kaq
4 shumë, ato u kthyen përsëri dhe hapën zjarr në shtëpi, në
5 fshatra në shkollë dhe në çdo gjë që e kishin përpara. Ata
6 gjithashtu vranë dhe Halit Gecin, mësuesin që ishte në shkollë
7 që punonte me nxënësit."

8 A është një përshkrim i saktë asaj që ndodhi në atë ditën
9 e betejës kjo, Dëshmitar?

10 PË. Po, e saktë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja 3, në
12 transkriptin në anglisht.

13 PY. Atëherë, pas këtij përshkrimi, Musë Jashari vazhdon e më
14 tej dhe thotë që UÇK-ja mori vendimin që të dilte haptazi në
15 skenë në varrimin e mësuesit, Halit Gecit, dhe vendimi u mor
16 nga Rexhep Selimi, nga Mujë Krasniqi dhe nga Daut Haradinaj
17 për të dalë haptazi në funeralin e mësuesit. Kjo përmbledhje e
18 ngjarjeve, a është gjithashtu e saktë, Dëshmitar, a ka ndodhur
19 realisht kështu?

20 PË. Realisht ka ndodh që në daljen publike ka qenë Rexhep
21 Selimi, Daut Haradinaj dhe Mujë Krasniqi. Por vendimi është
22 marrë nga Adem Jashari bashkë me ekipin, për me dalë në skenë.

23 PY. Në kohën e varrimit, ku keni qenë ju, Dëshmitar?

24 PË. Ne kemi qenë gjithë grupi kemi qenë rreth sigurisë së
25 varrimit për mirëmbajtjen e varrimit, për mirëmbajtjen edhe

1 mos po vijjnë forcat serbe dhe ne kemi qenë të pozicionum nëpër
2 pozita të ndryshme, në hyrje, nga hyrja e Skenderajt.

3 PY. Kush e ka lexuar deklaratën e parë publike të UÇK-së në
4 atë ceremoni varrimi, Dëshmitar?

5 PË. Në këtë ceremoni e ka lexu Rexhep Selimi.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Dëshmitari ka
7 dhënë kontekst të kuptimtë lidhur me këto intervista sa i
8 takon sulmit të armatosur dhe relevancës së këtij sulmi
9 përpara luftës. Ne, ky artikulli origjinal i Musë Jashari që
10 është sekuestruar nga banesa e Jakup Krasniqit, është vetëm dy
11 faqe. Dhe ne do kërkonim që të pranohej ky dokument ndërkohë
12 që intervista e Rexhep Selimit është më e gjatë. Megjithatë,
13 ne kërkojmë që të pranohen përkatësisht si rezultat i
14 përdorimit me Dëshmitarin 04401. Pra, në anglisht dhe në shqip
15 ZPS-ja kërkon që të pranohen në prova gjyqësore faqja
16 SPOE00131840 të intervistës së Rexhep Selimit dhe kërkojmë që
17 kjo faqe të mund t'i shtohet provës P1883. Ndërkohë që për sa
18 i takon dokumentit tjetër, do ta jap faqen përkatëse pak më
19 pas.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
21 kundërshtim?

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
24 SPOE00131840 pranohet në prova gjyqësore dhe do t'i shtohet
25 provës ekzistuese P1883, apo jo? Kjo ishte numri, ky ishte

1 numri i provës, z. Prokuror?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë, në qoftë se nuk do thotë

5 diçka Sekretari i seancës, do jap SPOE-në për dokumentin

6 tjetër që kërkojnë gjithashtu që të pranohet në provë

7 gjyqësore. Është SPOE00227510, deri në SPOE00227511 në shqip

8 dhe në anglisht.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
10 kundërshtim?

11 Përderisa nuk ka kundërshtim dokumentin SPOE00227510 deri
12 në SPOE00227511 -- ju kërkoj ndjesë, e thashë gabim. Atëherë,
13 dhe një herë është SPOE00227510 deri në SPOE00227511, në shqip
14 dhe në anglisht, pranohen në prova gjyqësore.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
16 të marrë numrin e provës P02032. Ju lutem, konfirmoni
17 klasifikimin.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Është publik.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
20 klasifikojeni si publik.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe faqja që iu shtua provës P1883
22 duhet që të klasifikohet si publik.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
24 klasifikojeni si publik edhe këtë faqe.

25 Z. HALLING: [Përkthim]

1 PY. Dëshmitar, tani do t'ju bëj disa pyetje shtesë për një
2 ngjarje që e keni përshkruar ju që ka ndodhur në fillim të
3 1998, tek intervista që keni dhënë për Zërin në vitin 2000.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem, të vendosni në ekran
5 materialin P1745, dhe konkretisht na nevojitet faqja 6D00-0771
6 në anglisht dhe në shqip është faqja SPOE00360474.

7 PY. Dëshmitar, do dalë në ekran tani.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Është faqja 12 në PDF. Po.

9 PY. Këtu keni folur për takimin e fundit me Adem Jasharin dhe
10 keni thënë kështu:

11 "Takimi i fundit me Adem Jasharin ka qenë në 4 mars në
12 Tika [Sipas përkthimit], ku kishim shkuar të vizitonim shokët
13 tanë të plagosur Sabit Geci, Musë Jashari dhe Sabit
14 Lladrovcin, të cilët u plagosën në betejën e Likoshanit.
15 Përveç Ademit kishte dhe shokë të tjerë si Rexhep Selimi,
16 Rrahman Rama, Remi dhe kështu me radhë. Jo vetëm që vizituam
17 shokët e plagosur, por folëm dhe për gjëra të tjera, për
18 zgjerimin e UÇK-së dhe për të pasur armatime më të mira."

19 Kjo është pjesa për të cilën do të doja t'ju bëja disa
20 pyetje. Pikë së pari, kur është, kur ka ndodhur beteja e
21 Likoshanit?

22 PË. S'më kujtohet data. Por dihet publikisht kur ka ndodh.
23 Dhe në këtë betejë janë plagos Sabit Geci, Musë Jashari dhe
24 Sabit Lladrovci.

25 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund të

1 përdor paragrafin 46 të shënimit përgatitor të rifreskojmë
2 kujtesën?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

4 Z. HALLING: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, ju keni thënë në seancën përgatitore që në
6 betejën e Likoshanit më 28 shkurt të 1999 -- [Sipas
7 përkthimit].

8 PËRKTHYESI: Nuk e kuptoj të gjithë pyetjen, më falni.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Më falni. Për përkthyesit, është
10 thënë në shënimin përgatitor:

11 "Krahas Rezallës së Re, ka qenë dhe beteja e Likoshanit
12 më 28 shkurt të vitit 1999 [Sipas përkthimit]".

13 A është kjo data e saktë, ju lutem?

14 PË. Po, e saktë. Por, nuk m'u kujtu për momentin thashë, nuk
15 m'u kujtu për momentin se është e saktë.

16 PY. A keni marrë ju pjesë në këtë betejë?

17 PË. Në betejë nuk kam marrë pjesë, kam shku në mbrëmje, kam
18 arrit bashkë me Adem Jasharin dhe grupin tjetër.

19 PY. Me aq sa keni ju dijeni, na përshkruani çfarë ka ndodhur
20 në këtë betejë?

21 PË. Në këtë betejë një grup i pjesëtarëve të Ushtrisë
22 Çlirimtare të Kosovës në atë kohë janë ballafaqu me forcat
23 serbe edhe në këtë ballafaqim kemi pas të lëndum këta tre
24 pjesëtarët. Të plagosur rëndë kanë qenë Sabit Geci, Musë
25 Jashari, pak ma lehtë dhe Sabit Lladrovci, po ashtu i plagosur

1 ma lehtë.

2 PY. Serbët, a kishin automjete të blinduara edhe helikopterë
3 edhe në betejën e Likoshanit?

4 PË. Po, ka pas shumë mjete të blindume. Edhe sa di unë kanë
5 qenë dy helikopterë të cilët kanë marrë pjesë në këtë betejë.

6 PY. UÇK-ja, a kishte ndonjë mortajë përveç armëve të lehta në
7 këtë betejë?

8 PË. Po, kemi pas në dispozicion edhe armë, mortaja dore. Por
9 nuk e di a kemi përdorur në këtë, a kanë pas në këtë kohë këta
10 pjesëtarë.

11 PY. Në takimin e Tikës [Sipas përkthimit], keni thënë që keni
12 parë Rexhep Selimin, Rrahman Ramën dhe Remin. Fillimisht për
13 kë Remi e keni fjalën këtu?

14 PË. Është mirë të korrigjohet. Jo Tikës, por Ticës. Në
15 fshatin Ticë. Edhe kam spjegu edhe nuk e di saktë a ka qenë
16 Rexhep Selimi në këtë kohë, por jemi taku. Nata e fundit ka
17 qenë e imja bashkë me komandantin legjendar Adem Jasharin më 4
18 mars, dhe në këtë takim po ashtu kemi, kam taku edhe Remin,
19 domethënë, Remi është Rustem Mustafa dhe Rrahman Rama në këtë
20 mbrëmje.

21 PY. Thatë që nuk e dini a ka qenë atje Rexhep Selimi, por ama
22 e keni përmendur këtë për gazetën Zëri në vitin 2000. Ajo që i
23 keni thënë gazetës Zëri, a është e saktë?

24 PË. Po, prapë nuk jam i sigurt, por ndoshta ka qenë edhe
25 Rexhep Selimi por nuk më kujtohet për arsye të rrjedhës se të

1 nesërmen që ka ndodh lufta më 5 mars edhe në Prekaz, por edhe
2 në fshatin tim, në Aqarevë. Nuk e di në këtë periudhë a ka
3 qenë Rexhep Selimi. Por nuk, s'jam i sigurt e kam thanë edhe
4 atje. Por jam i sigurt që këta të dy Rrahman Rama dhe Rustem
5 Mustafa kemi qenë bashkë.

6 Nuk po du me i ik as përgjigjes, as përgjegjësisë, por
7 nuk po, nuk jam i sigurt a ka qenë apo nuk ka qenë. Ndoshta
8 dhe ka mujt me qenë edhe, por nuk jam i sigurt. Edhe këtë e
9 thashë, edhe në seancën parapërgatitore të cilën e kem pas
10 bashkë. Megjithatë, ka kalu shumë kohë e gjatë edhe shumë
11 gjana po nuk po më kujtohen. Por po, kemi taku më 4 mars këta
12 të plagosurit dhe bashkërisht me Rrahman Ramën edhe Rustem
13 Mustafën edhe disa të tjerë kam ardh në shtëpinë time me 4
14 mars. Më 5 mars kanë fillu forcat serbe të sulmojnë edhe
15 familjen Jashari, por njëkohësisht kam spjegu edhe ma
16 gjanësisht që kanë fillu edhe forcat të shumta të vijnë edhe
17 në drejtim të fshatit tim ku e kam spjegu në detaje.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja të
19 përdorja paragrafin 42 të Shënimit Përgatitor 2.

20 PY. Sipas seancës përgatitore keni thënë që:

21 "Më vonë gjatë asaj dite keni parë Rexhep Selimin,
22 Rrahman Ramën dhe Rustem Mustafën për të diskutuar zgjerimin
23 e UÇK-së."

24 A është e saktë kjo që i keni thënë gazetës Zëri, pra, që
25 i keni parë më vonë gjatë ditës, Rexhep Selimin, Rrahman Ramën

1 dhe Remin?

2 PË. Diskutime nuk kemi pas më mundësi as që të diskutojmë më
3 5 mars për arsye se forca të shumta të cilat kanë ardh, nuk ka
4 pas asnjë, është thanë - tash ta nxjerrim kontekstin e
5 bisedimeve për zgjerimin - por është fol, edhe shpesh herë ne
6 kemi fol bashkë me Remin edhe me Rrahmanin edhe me të tjerët
7 që për zgjerimin e UÇK-së, por në këtë rast më 5 mars nuk kemi
8 pas asnjë mundësi që të diskutojmë, për arsye se në mëngjes
9 forcat serbe kanë fillu të hyjnë në fshatrat, siç i përmenda
10 më herët.

11 Sulmi ka ndodh në Prekaz, por njëkohësisht edhe forca të
12 shumta kanë ardh prej fshatrat rreth prej Jeshenice prej Peje
13 në drejtim të fshatit Aqarevë.

14 PY. Po. Dëshmitar, s'e kam për 5 marsin tani. E kam për
15 Ticën, më 4. Me sa ju kujtohet ju, në vitin 2000, a mos i
16 kishit më të freskëta ngjarjet nga ç'i keni aktualisht?

17 PË. Ka mundësi që ka qenë Rexhep Selimi, po them edhe në
18 Ticë, por më 5 mars nuk e, në Aqarevë nuk ka qenë. Ka mundësi
19 që ka qenë më, në Ticë edhe shumë, se ka pas edhe shumë shokë
20 të tjerë të cilët atë ditë rastësisht jemi ndodh në Ticë. Por
21 besoj që mundet me qenë e saktë, dhe mundet me qenë e pasaktë.
22 Nuk jam i sigurt.

23 Por ndoshta edhe kjo intervistë që kam dhanë ma herët,
24 ndoshta është ma e freskët edhe ndoshta ka qenë Rexhep Selimi.
25 Nuk e di. Mundet me qenë.

1 PY. Të flasim tani për sulmin më 5 mars në Prekaz. Atë ditë a
2 keni qenë ju në Aqarevë?

3 PË. Atë ditë kam qenë në Aqarevë dhe jam përgatit me shku në
4 ndihmë, se fillun forcat. Në mëngjes më kanë njoftu edhe roja
5 e fshatit, të cilët në këtë periudhë kanë pas një jetë ma të
6 organizume, edhe disa ushtarë të cilët kanë ba roje dhe në
7 pozicione të cilat i kam pas. Dhe jam përgatit që të shkoj në
8 ndihmë të Adem Jasharit.

9 Duke u përgatit kanë ardh edhe forca të tjera prej, në
10 drejtimin të Pejës dhe kanë zhvillu te hymja, fshatin
11 fillimisht Kopiliq, është para fshatit Aqarevë, dhe në atë
12 moment ne i kemi pas pozicionet, në atë moment ne jemi
13 ballafaqu në luftime bashkë me ta. Edhe unë kam qenë në vijën
14 e parë dhe përgjigjen e parë është dha prej meje dhe disa
15 bashkëluftëtarëve të mi që edhe ne i kemi ndalu forcat serbe
16 pa hi në fshatin Aqarevë.

17 PY. Nga marsi deri në prill të 1998, në Aqarevë keni qenë i
18 stacionum?

19 PË. Unë kam qenë i stacionum shumicën e kohës në shtëpinë
20 time, në fshatin tim, edhe deri te një pjesë bukur të madhe e
21 kam kalu aty.

22 PY. Në të njëjtën periudhë, ku kanë qenë të stacionuara
23 forcat serbe në zonën tuaj, në territorin tuaj?

24 PË. Në të njëjtën periudhë kanë qenë të pozicionuar në
25 Jeshenicë, Turiqevc, Rakinicë, gjithashtu në hyrje të fshatit

1 Llaushë, dhe të pozicionuar në Prekaz dhe rreth Prekazit. Flas
2 për fillimet 5, 6 dhe 7 marsit, më tutje. Kurse unë kam qenë i
3 pozicionum përballë tyre bashkë me disa ushtarë dhe çdo ditë
4 gati thuaj kemi pas konfrontime mes veti.

5 PY. A ka qenë ndonjë kryqëzim Skenderaj-Klinë ku kishte forca
6 serbe?

7 PË. Po, në fshatin, udhëkryqit në Turiqevc. Ku është një
8 udhëkryq edhe është hyrja për fshatin Kopiliq, Aqarevë, është
9 hyrja për, në brendësi të Turiqevcit, dhe është magjistranja
10 Skenderaj-Klinë. Dhe ky udhëkryq, këto forca janë pozicionu në
11 këtë udhëkryq, në një pjesë në Rakinicë, dhe në një pjesë
12 bazën e kanë pas në Jeshenicë, edhe lëvizja ka qenë, këto
13 forcat kryesisht kanë ardh prej Peje dhe kanë qarkullu dhe
14 ndërrimi është bërë në këtë pjesë, këtyre forcave.

15 PY. Gjatë kohës që serbët po vazhdonin sulmet në këtë
16 periudhë, a mos përdorët, po përdornin gjithnjë e më shumë
17 armatime të rënda kundër UÇK-së?

18 PË. Faktikisht, kanë qenë forca ushtarake policore, edhe
19 arsenali i tyre ka qenë shumë i madh. Por në këtë kohë, kanë
20 përdor edhe armatim të raketahedhëse, kur në këtë, gjatë kësaj
21 periudhe mbas disa ditësh, është sulmu edhe shtëpia ime, edhe
22 është dëmtu bukur rëndë. Kam pas edhe familjen aty, m'u kish
23 plagu edhe vëllau, Fidan Selimi, dhe në këtë periudhë e kam
24 pas edhe një grup shokësh të cilët bashkë ka qëllu edhe Bekim
25 Berisha në këtë periudhë kur m'u ka sulmu edhe shtëpia dhe më

1 është dëmtu.

2 PY. Me për afërsi, a ju kujtohet kur ka ndodhur sulmi në
3 shtëpinë tuaj?

4 PË. Nuk më kujtohet saktë, prapë me data jam shumë keq, edhe
5 i harroj. Mirëpo, besoj që ka qenë edhe mediale, megjithatë
6 nuk më kujtohet saktë, nuk e di mbas sa periudhe është sulmu.
7 Edhe ne pse ishim në pozicione dhe ishim në luftime afër me
8 ta, unë jam, shtëpia e ime ka qenë në brendësi, por është
9 sulmu me raketa.

10 PY. Që ta sqarojmë datën, me aq sa të mundeni. Thatë që
11 "ishte me për afërsi dikund". Më saktë çfarë keni dash të
12 thoni, për cilën periudhë?

13 PË. Po flas për periudhën mbas 5 marsi. Nuk e di saktë a ka
14 qenë dy javë a tri javë, apo ma herët a ma vonë, nuk e di, por
15 gjatë luftimeve është sulmu edhe, është qellu edhe shtëpia
16 ime. Disa shtëpi të tjera, por në veçanti është sulmu shtëpia
17 ime dhe është dëmtu, ku unë kam pasur edhe familjen brenda.
18 Për rastësi ka ndodh që edhe brenda të jetë edhe Bekim Berisha
19 edhe Abeja, dhe i ka fut të gjithë anëtarët e familjes në
20 bodrum që të mos dëmtohen.

21 PY. Faleminderit.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga
23 ekrani.

24 PY. Tani dua të flasim për rekrutët e UÇK-së, personat që po
25 rekrutonte UÇK-ja, që po vinin në zonën e Drenicës në

1 pranverën e 1998. A erdhën në zonën tuaj të rekrutuar nga UÇK-
2 ja?

3 PË. Po, ka pas mbas ramjes së komandantit legjendar Adem
4 Jashari më 5 mars, është mobilizu jo vetëm Drenica, por ka pas
5 të mobilizum edhe nga vendet, edhe nga perëndimi, por edhe nga
6 vende të ndryshëm, dhe në këtë periudhë unë kam pas pozicione
7 dhe luftimet që i kisha, kisha një jetë ma të organizume edhe
8 kisha njerëz ma shumë të sistemum në kuadër, në përgjegjësinë
9 time. Dhe, por ka pas shumë njerëz të cilët kanë ardh në
10 Drenicë dhe në veçanti në fshatin tim, Aqarevë, përveç Bekim
11 Berishës, Abesë, edhe Kadri Xhemajlit -- Kadri Hamitit, po më
12 duket, a Xhemajlit, nuk e di edhe mbiemrin. Atëherë i
13 thirrshim CD-ja. Dhe Fehmi Lladrovci me Xhevë Lladrovci dhe
14 shumë bashkëluftëtarë të tjerë të cilët fillimisht kanë ardh
15 për ta në Aqarevë. Dhe ka pas shumë të tjerë të cilët kanë
16 ardh dhe janë shpërnda, nëpër, ma vonë edhe nëpër zona të
17 tjera.

18 PY. Që ta sqarojmë për procesverbal, se keni përmendur dy
19 herë këtë person. Kush është ky person, Abi?

20 PË. Abeja, jo Abi, është Bekim Berisha, dëshmor i kombit dhe
21 luftëtar jashtë -- shumë i zoti. Bashkë me të ka qenë edhe --

22 PY. Domethënë, ishte nofka kjo, Abeja ishte nofka? Dëshmitar,
23 pohuat me kokë, por, ju lutem, thojeni më zë.

24 PË. Thashë, "po", por me siguri nuk u dëgjova.

25 PY. Faleminderit. Këta persona që ju vinin në zonën tuaj, kë

1 kishin përgjegjës, domethënë kush ishte përgjegjës për të
2 sistemuar oficerët e nivelit të lartë në atë grup që po vinin,
3 po mbërrinin në zonën tuaj?

4 PË. Këta kanë qenë kryesisht vullnetarë edhe janë, kanë shku
5 në ato pjesë ku ka pas luftime ose ku ka pas pjesëtarë të UÇK-
6 së. Në këtë rast kanë ardh te unë, por kanë shku edhe në pjesë
7 të tjera si në Prekaz apo në grupe të tjera. Për këtë periudhë
8 kam qenë unë përgjegjës për pritjen dhe organizimin e këtij
9 formacioni në, përballë forcat serbe.

10 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund të
11 shohim paragrafin 52 të shënimit përgatitor për një
12 mospërputhje?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

14 Z. HALLING: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, ju keni thënë kështu në seancën përgatitore që
16 të sigurohemi që e kemi kuptuar drejt. Ju keni thënë:

17 "Shtabi i Përgjithshëm ndihmoi vetëm për sistemimin e
18 oficerëve të lartë që erdhën në zonë, të gjithë që ishin në
19 një nivel më të ulët janë trajtuar nga zona e vet."

20 A është kjo e saktë?

21 PË. Shumica e të ardhurve normal që kanë ardh përmes njerëzve
22 të cilët dhe kanë pas njohuri. Edhe unë e kam tha që kanë ardh
23 përmes anëtarëve, përmes Shtabit të Përgjithshëm. Normal që
24 këta kanë ardh jo pa, jo në krye më vete.

25 PY. Që të sigurohemi, mund të përgjigjeni me "po" apo me

1 "jo". A është e saktë ajo që keni thënë në seancën
2 përgatitore?

3 PË. Po, e saktë.

4 PY. Faleminderit. U sqarua. Në maj të 1998, a keni vepruar
5 në Likovc ju?

6 PË. Po.

7 PY. Në kuadër të detyrave që kishit fillimisht si komandant
8 zone, a krijuat dhe një spital?

9 PË. Po. Në kuadër të zonës ka qenë spitali ushtarak ku janë
10 trajtu edhe civilë edhe ushtarë. Ka qenë një ambulancë e një
11 spitali, gjithashtu ka qenë një emergjencë civile në kuadër të
12 Nënë Terezës në këtë kohë, dhe ka qenë një organizim i jetës
13 ma shumë i qytetarëve brenda kësaj periudhe në Likovc.

14 PY. Fizikisht, ku ka qenë spitali në raport me zyrat
15 qendrore?

16 PË. Besoj që diku, afërsisht 1 kilometër larg objekti, ku ka
17 qenë objekti i zonës. Ose edhe ma afër pak, nuk e di,
18 për afërsisht.

19 PY. Që ta sqarojmë, cila ndërtesë përdorej për shtabin e
20 zonës?

21 PË. Ka qenë një objekt ku është përdor përpara nga policia e
22 mahershme. Ka qenë një stacion i policisë në Likovc, në kuadër
23 të bashkësisë lokale.

24 PY. Të flasim pra për spitalin, kush ka qenë doktor atje në
25 zonën e Likovcit, në spitalin e Likovcit?

1 PË. Në spitalin e Likovcit ka pas shumë doktorë që kanë ardh
2 prej Prishtine, po në veçanti mund të përmendim Fadil Beka, i
3 cili ka qenë gjithmonë i pranishëm edhe krah ushtarëve të
4 plagosur. Por ka pas dhe shumë doktorë të tjerë që kanë ardh
5 me asistuar në operacionet e ndryshme në Likovc, në këtë spital.

6 PY. Keni folur me gazetën Zëri dhe me të tjerë dhe keni thënë
7 që duhet të shkonit në Abri në një moment për shkak të forcave
8 serbe. A u zhvendos edhe spitali në atë kohë?

9 PË. Spitali është pak para se me hi forcat serbe, është
10 evaku, gjithë të plagosurit dhe është tërësisht edhe spitali,
11 një pjesë, domethënë, çka kanë qenë në spital janë tërësisht prej
12 kësaj godine.

13 PY. Në atë kohë, ku u zhvendos, ku u çua spitali?

14 PË. Ma nuk kishim mundësi për një pjesë me e trajtuar në Abri,
15 disa të plagosur, pastaj në Baicë, pastaj ka lëvizur në vende të
16 ndryshme, për arsye të luftimeve të cilat dhe depërtimi i
17 forcave serbe në këtë hapësirë, në këtë territor, domethënë,
18 Likovc dhe fshatra përreth.

19 PY. Një pjesë e spitalit mos u vendos në Baicë?

20 PË. Dr. Fadil Beka, Gani Halili, disa të tjerë kanë marrë të
21 plagosurit, varësisht ku kanë pas hapësirë në një shtëpi apo në
22 një objekt që t'i bartin dhe t'i trajtonin. Një ndër të
23 plagosurit më duket është e saktë, ka qenë edhe vëllau tjetër
24 i plagosur, Selmani, Selman Selimi, edhe disa të tjerë të
25 cilët janë trajtuar në vende të ndryshme. Ka pas fillimisht janë

1 bartë deri në Abri, prej Abrije janë mbart prapë në Baicë, por
2 prej Baice janë mbart edhe në vende të ndryshme të plagosurit,
3 dikur në këtë periudhë i kemi pas shumë të plagosur dhe janë
4 trajtu në vende të ndryshme. Po, por fillimisht ka qenë Baica,
5 domethënë, edhe ka pas edhe në Abri edhe në Baicë. Që me iu
6 përgjigj saktë pyetjes suaj.

7 PY. Tani për Fadilin dhe të tjerët, Fadil Bekën dhe të
8 tjerët, a shkonin dhe ata në Abri dhe në Baicë gjatë kohës kur
9 u zhvendos spitali?

10 PË. Spitali nuk ka mujt më të jetë operacional, domethënë
11 mjetet të cilat nuk kanë mund të mbarten të lëvizin, por me aq
12 sa kanë pas mundësi me ato mjete të cilat i kanë pas me vete,
13 ata i kanë jep ndihmë edhe me Abrinë edhe me, kanë shku bashkë
14 me plagosurit, duke u tërhjek prej zonave të luftimit.

15 PY. Likovci a është përdorur ndonjëherë si pikë takimi nga
16 Shtabi i Përgjithshëm, Dëshmitar?

17 PË. Në një rast ka ndodh, kemi mbajt një takim. Këtë e kam
18 shpjegu, po.

19 PY. E di se ndonjëherë ju keni shpjeguar disa gjëra në
20 seancën përgatitore, megjithatë është e rëndësishme që për
21 çështje procedure të çështjes penale ju të thoni, të jepni
22 shpjegimet dhe një herë tjetër. A mund të na e thoni se për
23 çfarë takimi bëhet fjalë këtu, çfarë takimi përshkruani,
24 Dëshmitar?

25 PË. E saktë. Po, e saktë.

1 PY. Pra, një herë t'i thua që u bë një takim. A mund të na
2 shpjegonim për çfarë takimi e keni fjalën?

3 PË. Me komandantët e zonave ne kemi mbajtur një takim ku ka
4 qenë prezent edhe Sokol Bashota. E kam shpjeguar edhe në këtë
5 takim është mbajtur në nivel zone dhe Shtabit të Përgjithshëm.

6 PY. A ju kujtohet përafërsisht kur ka ndodhur ky takim?

7 PË. Saktësisht prapë nuk e di, por është dikund mbasi jam
8 zgjedhur komandant zone, dikund, periudha e saktë prapë nuk e
9 di.

10 PY. A ju kujtohet se çfarë është diskutuar në këtë takim, apo
11 thjesht ju kujtohet që ka ndodhur si takim?

12 PË. Vetëm më kujtohet që ka ndodhur një takim edhe ka pas edhe
13 takime të tjera të nivelit politik, kur ne jemi sqaruar, ku
14 përveç këtij takimi që më kujtohet ka pas edhe në nivel të, ma
15 vonë e kam shpjeguar, të, ambasadori Hill po më duket, edhe
16 dikush tjetër.

17 PY. Atëherë, duke u mbështetur tek përgjigjja që thatë në
18 fund, Shtabi i Përgjithshëm e ka përdorur Likovcin për takime
19 dhe me ndërkombëtarët, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. E ka përdorur këtë takim, ka pas, domethënë, edhe anëtarë
21 të Shtabit të Përgjithshëm që kanë marrë pjesë në këtë takim,
22 po.

23 PY. Tani dëshiroj që të flasim për njerëzit në zonën tuaj.
24 Keni përmendur që keni filluar me detyrën e komandantit të
25 zonës në maj të vitit 1998. Tani do ju pyes lidhur me rolet e

1 personave të tjerë në Drenicë në atë kohë. Kështu që do i marr
2 njëri pas tjetrit.

3 Atëherë, duke filluar me shtabin e zonës. A mund të na
4 thoni se çfarë roli apo çfarë detyre ka pas Sami Lushtaku?
5 PË. Sami Lushtaku ka qenë zëvendëskomandant i zonës operative
6 të Drenicës, zëvendës i imi.

7 PY. Po Rasim Kiqina, çfarë roli ka pas ai në zonë?

8 PË. Ka pas në zbulim dhe kundërzbulim, pastaj edhe me, në
9 kuadër të Brigadës 111 është, ka qenë i angazhum.

10 PY. Kur thoni që ka qenë në zbulim-kundërzbulim, a e keni
11 emëruar ju atë në këtë postin e zbulim-kundërzbulimit, apo jo?

12 PË. Po, unë e kam emëru.

13 PY. Ai, a ka qenë oficer i nivelit të lartë, punonjës i
14 nivelit të lartë?

15 PË. Ka qenë shok i imi dhe ka qenë oficer, domethënë, ka qenë
16 i, në detyrën e oficerit në zonë.

17 PY. Në dëshminë e dhënë që është pranuar si provë gjyqësore
18 keni folur gjithashtu edhe për njësitin e Sabit Gecit. Rasim
19 Kiqina ka qenë pjesë e njësitit të Sabit Gecit që e keni
20 përshkruar në dëshminë tuaj, Dëshmitar?

21 PË. Jo, asnjëherë nuk ka qenë Rasim Kiqina, por Rasim Kiqina
22 ma vonë është emëru nga unë në zonën operative të Drenicës, si
23 bashkëluftëtar.

24 PY. Sa i takon Shaban Shalës, e përmendët pak më herët.

25 Megjithatë, na sqaroni dhe një herë tjetër çfarë posti zyrtar

- 1 ka pas ai, pra, Shaban Shala në zonën e Drenicës?
- 2 PË. Ka qenë i, për marrëdhënie ushtarake civile dhe për
3 kryesisht në marrëdhënie me publikun edhe mediat. Dhe
4 gjithmonë ka qëndru në objektin e shtabit të zonës për të
5 pritur ose me delegacion ose media se kur, ose edhe qytetarë
6 ose politikanë ndoshta.
- 7 PY. Po Shaban Shala a ka pasur kontakte në Shtabin e
8 Përgjithshëm, Dëshmitar?
- 9 PË. Besoj që ka pas kontakte edhe me Shtabin e Përgjithshëm.
- 10 PY. Po Fadil Demaku, çfarë roli, çfarë detyre ka pas ky
11 person në zonën e Drenicës?
- 12 PË. Fadil Demaku ka qenë në kuadër të informimit, domethënë,
13 bashkërisht edhe me Tahir Deskun por edhe me, edhe në
14 koordinim e Shaban Shalën.
- 15 PY. Fadil Demaku, a ka punu për Shaban Shalën?
- 16 PË. Ka punu në ekip edhe me Shaban Shalën, edhe me, në ekip
17 edhe me mu edhe, domethënë, kryesisht u merrte me
18 riorganizimin e mediave ose të informimit.
- 19 PY. Fadil Demaku, a ka pas lidhje gjaku me Xhahir Demakun?
- 20 PË. Jahir Demaku është vëllau, janë vëllazër.
- 21 PY. Përpara një çasti në përgjigjen tuaj ju përmendët Tahir
22 Deskun. Po Tahir Desku a ka punuar për Shaban Shalën?
- 23 PË. Tahir Desku ka punu në kuadër të zonës operative të
24 Drenicës, ka qenë raportues dhe vazhdimisht ka punu edhe me
25 Shaban Shalën.

- 1 PY. A mund të komunikojë në anglisht Tahir Desku?
- 2 PË. Po, Tahir Desku ka dit edhe anglisht.
- 3 PY. Tani të kalojmë te brigadat. Po flisnim për Jahir
- 4 Demakun. A mund të na thoni çfarë roli ka pas Jahir Demaku,
- 5 Dëshmitar?
- 6 PË. Ka qenë komandant i Brigadës 111.
- 7 PY. A njihet kjo si njësitë special i zonës së Drenicës, po
- 8 ashtu?
- 9 PË. Po, ashtu.
- 10 PY. Po Nexhat Demaku, kush është ky person?
- 11 PË. Është vëllau i Jahir Demakut. I Fadil Demakut.
- 12 PY. Në çfarë brigade ka vepru ai?
- 13 PË. Nexhati s'e di saktësisht, por besoj që në Brigadën 111
- 14 edhe po ashtu edhe vëllau i tij Xhevat Demaku, dëshmor i
- 15 kombit, ka qenë pjesëtar i Brigadës 111.
- 16 PY. Nexhat Demaku, a ka qenë vetëm një ushtar i thjeshtë në
- 17 atë brigadë?
- 18 PË. Po, vetëm ushtar i thjeshtë.
- 19 PY. Tani të kalojmë në Brigadën 112. Kush ka qenë komandant i
- 20 Brigadës 112?
- 21 PË. Komandant i Brigadës 112 ka qenë Mujë Krasniqi.
- 22 PY. Po komandant i Brigadës 113, kush ka qenë?
- 23 PË. Brigadës 113. Më fal, gabim. Brigadës 113 ka qenë
- 24 dëshmori Mujë Krasniqi kurse Brigadës 112 ka qenë Abedin
- 25 Rexha. Se e ngatërrova. Domethënë, komandant i Brigadës 112 ka

- 1 qenë Abedin Rexha, kurse komandant në Brigadën 113, ka qenë
2 Mujë Krasniqi.
- 3 PY. Faleminderit për sqarimin. Sa i takon Brigadës 112,
4 Abedin Rexhës, si komandant i Brigadës 112, a mund të na thoni
5 çfarë nofke ka pas ai?
- 6 PË. Sandokani.
- 7 PY. Tani kalojmë te Brigada 113. Mujë Krasniqi, si e ka pas
8 nofkën?
- 9 PË. Kapuçi.
- 10 PY. Vazhdojmë të qëndrojmë në këtë brigadë. Bedri Gashi, kush
11 është? A ka ardhur ndonjëherë ai në Drenicë?
- 12 PË. Bedri Gashi, e kam sqaru edhe një herë në qoftë se
13 mendojmë për një Bedri Gashi i cili është, ka qenë edhe është
14 një bashkëluftëtar i Mujës nga fshati Cabiq.
- 15 PY. Si bashkëluftëtar i Mujë Krasniqit, a domethënë që ai ka
16 qenë pjesë e Brigadës 113?
- 17 PË. Ai ka qenë pjesë e Brigadës 113.
- 18 PY. Po Mirush Daka?
- 19 PË. Po ashtu Mirush -- edhe ky ka qenë pjesë e Brigadës 113.
- 20 PY. Përpara se sa të bëhej pjesë e kësaj brigade, a ka qenë
21 gjithashtu ai komandant njësitit?
- 22 PË. Sa di unë, po. Edhe ky ka pas një bashkë me Mujën edhe me
23 pjesën tjetër të Sokolit, me --
- 24 PY. Kur thoni Sokoli, për kë e keni fjalën?
- 25 PË. Për Sokol Bashotën.

- 1 PY. Kam dëgjuar për të. Po Mirush Daka çfarë nofke kishte?
- 2 PË. S'po më kujtohet. Po më duket "Korbi".
- 3 PY. Dikur gjatë luftës, a u vra Mirush Daka?
- 4 PË. Po.
- 5 PY. A dini ndonjë gjë lidhur me rrethanat se si ka vdekur ai?
- 6 PË. Jo, nuk e di.
- 7 PY. Kalojmë më tej me personin e radhës. Ramadan Gashi, kush
- 8 është ky person?
- 9 PË. Pjesë e Brigadës 113. Pjesëtar i Brigadës 113.
- 10 PY. A ju kujtohet se çfarë roli ka luajtur ai gjatë luftës?
- 11 PË. Jo, nuk më kujtohet, në kuadër të Brigadës 113.
- 12 Fillimisht ka qenë i angazhum me, bashkë me Mujën por, në
- 13 kuadër të brigadës nuk e di çfarë roli ka pas.
- 14 PY. Kalojmë më tej. Skënder Halilaj.
- 15 PË. Skënder Halilaj pjesëtar në Brigadën 113, dhe familja e
- 16 tij i ka dy dëshmorë. Babën edhe vëllaun.
- 17 PY. Ai ka qenë vetëm ushtar i thjeshtë në atë brigadë?
- 18 PË. Po.
- 19 PY. Po Zeqir Demaku, edhe ai ka qenë ushtar i thjeshtë në
- 20 Brigadën 113?
- 21 PË. Edhe ai, sa më kujtohet ka qenë ushtar i thjeshtë në
- 22 Brigadën 113.
- 23 PY. Tani të kalojmë te Brigada 114. Kush ka qenë komandant i
- 24 Brigadës 114?
- 25 PË. Komandant i parë ka qenë Fehmi Lladrovci, pastaj, mbas

1 ramjes së tijna, pas, është, ka qenë Ilaz Kodra, gjithashtu
2 edhe ai dëshmor.

3 PY. A mund ta përshkruani shkurtimisht Fehmi Lladrovcin,
4 domethënë, si ishte si paraqitje? Na e përshkruani dot?

5 PË. Fehmia ka qenë një veprimtar i hershëm i lëvizjes, edhe
6 shok i Adem Jasharit, grupit të Adem Jasharit. Edhe një
7 personalitet mjaft i shquar me, jo vetëm në Drenicë por edhe
8 në përgjithësi në Kosovë.

9 PY. Pyetja ime kishte të bënte me paraqitjen, me tiparet
10 fizike, në qoftë se mund të na e përshkruani. Si ka qenë, si
11 paraqitje?

12 PË. Një burrë i zoti, i gjatë, i respektueshëm, me një
13 karakter të fortë.

14 PY. Personi tjetër, Nuhi Geci. Kush është Nuhi Geci?

15 PË. Është dëshmor, dhe ka qenë pjesë e Brigadës 114.

16 PY. Tani të kalojmë te policia ushtarake. Kush ka qenë
17 komandanti i policisë ushtarake?

18 PË. Ka qenë Sahit Jashari.

19 PY. Ku e ka pas bazën, ku ka qenë i stacionuar Sahit Jashari?

20 PË. Sahit Jashari ka qenë, është i Prekazit, edhe shok i Adem
21 Jasharit. Ka qenë i pozicionuar në Likovc.

22 PY. Sahit Jashari, a është vëllai i Musë Jasharit që ne e
23 diskutuam pak më herët?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Po Fatmir Mehmeti, kush është ky person?

- 1 PË. Fatmir Mehmeti ka ardhur bashkë me grupin e Sami
2 Lushtakut, kur kanë ardh me Fehmi Lladrovcin, grupi mbas 5
3 marsit, dhe është, ka qenë një periudhë të shkurtër si
4 zëvendëskomandant i policisë ushtarake në Likovc.
- 5 PY. Vazhdojmë me personin tjetër. Faleminderit. Muharrem
6 Xhemajli, kush është ky person?
- 7 PË. Pjesëtar i Brigadës 113. Dhe më vonë me sa më duket, ka
8 kalu me policinë ushtarake. Nuk jam i sigurt.
- 9 PY. Po Fatmir Gjilani, personi i fundit për të cilin dua t'ju
10 pyes, kush është ky person?
- 11 PË. Thashë, Fatmir Gjilani ka ardh bashkë me grupin, pas 5
12 marsit me grupin e Samisë, Sami Lushtaku, Fatmir Limaj, po më
13 duket, grupi i parë kur ka ardh. Fehmi Lladrovci, Abeja,
14 bashkë me ta ka qenë edhe Fatmiri. Dhe fillimisht ka ardh në
15 Drenicë pastaj ka kalu në zonën operative të Karadakut më
16 duket.
- 17 PY. Dëshmitar, a mund ta përsërisni dhe një herë fundin e
18 fjalisë së fundit, edhe a mund të flisni pak me zë më të lartë
19 për t'ju dëgjuar më mirë?
- 20 PË. Po, thashë Fatmir Gjilani është -- Fatmir Gjilani, jo,
21 Fatmir Mehmeti, qe fjala për Fatmir Mehmetin.
- 22 PY. Tani po flas për Fatmir Gjilanin. Kështu që dua të di
23 diçka lidhur me të. Mund ta përshkruani këtë person?
- 24 PË. Unë, tashti, unë mendoj që i njëjti person, që po flasim.
25 Fatmir Gjilani nuk e di kush është, por Fatmir Mehmeti, nga

1 Gjilani. Ose është kjo një --

2 PY. Për sa kohë qëndroi ky person në zonën e Drenicës?

3 PË. Nuk e di saktë. Besoj që --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për këtë person
5 e keni fjalën?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Po thotë që është i njëjti person,
7 kështu që po përqendrohem te personi, prandaj e bëra kështu
8 pyetjen dhe dua tani të di për sa kohë qëndroi.

9 PY. Dëshmitar, ju thatë që nuk e dini ekzaktësisht.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja që
11 të kalojmë në paragrafin 79 i Shënimit Përgatitor numër 2, në
12 mënyrë që t'i rifreskojmë memorien, kujtesën, personit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

14 Z. HALLING: [Përkthim]

15 PY. Ju thoni, Dëshmitar, që:

16 "Fatmir Gjilani ka qëndruar në Drenicë vetëm për 1-2
17 muaj, rreth mesit të vitit 1998, dhe pjesërisht ka qëndruar me
18 ju."

19 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Besoj që është e saktë, domethënë. Nuk e di thashë edhe
21 më herët, nuk e di saktë sa ka qëndru, por besoj që një
22 periudhë dy muaj, mundet me qenë ose ma tepër ose ma pak.

23 Z. HALLING: [Përkthim] E vë re kohën, megjithatë, mendoj
24 që mund të bëjmë dy gjëra të shkurtra për dy minuta, kështu që
25 në qoftë se do mundesha, do kërkoja që të paraqitet një

1 dokument në ekran që është prova P1753, në faqen 08097 [Sipas
2 përkthimit], është një fotografi.

3 PY. Dua t'ju tregoj një fotografi, Dëshmitar, dhe pasi të
4 shohim fotografinë do bëjmë pushimin e drekës. Atëherë, të
5 shohim fotografinë në fund të faqes, në të majtë. Shikoni
6 numrat aty që janë mbi kokat e personave. A mund ta thoni
7 personi që ka numrin 1 sipër, me atë shigjetën, kush është ky
8 person?

9 PË. Personi numër 1 është Fatmir Limaj, personi numër 2 është
10 Musë Jashari; personi numër 3, Fatmir Mehmeti; personi numër 5
11 është Sahit Jashari. Personi numër 4, si fytyrë e njofshme,
12 por nuk po më kujtohet emri dhe nuk e di cili është.

13 PY. Fatmir Limaj dhe Musë Jashari, a kanë qenë në zonën e
14 Drenicës si edhe vetë ju?

15 PË. Jo, nuk kanë qenë asnjherë. Musë Jashari dhe Fatmir
16 Limaj kanë qenë në zonën e Pashtrikut.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që
19 është momenti i përshtatshëm për të bërë pushimin tani.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
21 tani kemi pushimin e drekës për një orë e gjysmë. Do vijmë
22 këtu në orën 14.30 edhe do vazhdojmë deri në orën 16.30.

23 Mund të largoheni nga salla tani.

24 [Dëshmitar përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë

1 pushim deri në orën 14.30.

2 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

3 --- Seanca rifillon në orën 14.30

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
5 uleni. Sillni dëshmitarin në sallë.

6 Në orën 3.30 do bëjmë dhjetë minuta pushim.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni.

9 Do vazhdojmë -- do vazhdojmë me pyetjet e Prokurorisë
10 tani.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Dhe mirëditë, Dëshmitar. Përpara pushimit po flisnim për
13 rolet që kishin persona të ndryshëm kur keni qenë ju komandant
14 zone në vitin 1998. Janë edhe tre persona të tjerë, Prizreni
15 të cilët dua t'iu pyes.

16 I pari, Isni Thaçi. Hysni ose Isni Thaçi. Çfarë roli ka
17 pasur ky person gjatë luftës?

18 PË. Ka qenë ushtar i thjeshtë dhe ka qenë si truproje i z.
19 Thaçi ose shoqërues.

20 PY. Kur thoni "Z. Thaçi", e keni fjalën për z. Hashim Thaçi?

21 PË. Po.

22 PY. Kur thatë keni qenë shoqërues i z. Thaçi, a ndodhte
23 ndonjëherë që të ishte në zonën e Drenicës Isni Thaçi?

24 PË. Po.

25 PY. Në rregull. Dy personat e tjerë, Ajaz -- Ajez Berisha dhe

1 Ferat Shala. [Përkthyesja: Shqiptimi sipas Prokurorit]. A kanë
2 qenë ndonjëherë këta dy persona në zonën e Drenicës?

3 PË. Fillimisht kanë qenë, e pastaj kanë kaluar në Shtabin e
4 Përgjithshëm.

5 PY. Kur kanë qenë në Drenicës, në cilin njësit kanë qenë?

6 PË. Në -- sa më kujtohet mu, kanë qenë në njësitin Pëllumbi.

7 PY. Kush e drejtonte këtë njësit?

8 PË. Përgjegjësi i njësimit Pëllumbi ka qenë Ferat Shala.

9 PY. Tani, ju thatë "Pas disa kohësh kaluan në Shtabin e
10 Përgjithshëm". A ju kujtohet me përafërsi, kur u larguan nga
11 zona juaj për të shkuar në Shtab?

12 PË. Nuk e di saktë. Por e di që kanë kalu me Shtabin e
13 Përgjithshëm.

14 PY. Po me përafërsi, me përafërsi, kur mund të ketë ndodhur
15 kjo? Je në gjendje të na e thuash?

16 PË. Diku nga fundi i vitit 1998, ose përpara nuk jam -- nuk
17 jam i -- nuk jam i saktë, nuk e di. Mund me qenë edhe më
18 herët.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja të
20 shihja paragrafin 45 të Shënimit Përgatitor 2, që t'i rikujtoj
21 kujtesën.

22 PY. Dëshmitar, ju keni thënë kështu, sipas shënimit
23 përgatitor:

24 "Ajaz Berasha [Sipas përkthimit] dhe Ferat Shala, të dy
25 fillimisht kanë qenë në zonën e Drenicës. [Ju besonit] se

1 Ferat Shala drejtonte këtë njësit dhe mund të ketë pasur
2 nofkën Pëllumbi. Diku mes prillit-majit të vitit 1998, të dy
3 këta persona u larguan nga zona dhe shkuan pranë Shtabit të
4 Përgjithshëm dhe [ju nuk] e dini se çfarë detyrash kanë pasur
5 ata në Shtabin e Përgjithshëm."

6 A është e saktë kjo?

7 PË. Mund të jetë e saktë. Nuk e di saktë në cilin muaj, por
8 kam mendu dhe edhe mendoj se në q'atë fillimin e vitit
9 nëntëdhj -- ka mesi ose fillimi i vitit 1998, kanë shku -- nuk
10 kanë qenë më në zonë. Po mund të jetë e saktë.

11 PY. Pra, ju keni thënë që mund të jetë e saktë. Kur thoni
12 "Mund të jetë e saktë", e keni fjalën që mund të ketë qenë
13 prilli-maji i vitit 1998?

14 PË. Po ndoshta ka qenë prilli-maji. Nuk -- për atë arsye nuk
15 jam i saktë për -- edhe ka kalu edhe kohë e gjatë dhe -- dhe
16 unë mendoj që është po ai muaj. Mendoj që është e saktë.

17 PY. Kuptoj. Gjatë kohës që keni qenë komandant i zonës së
18 Drenicës, a ka ndodhur ndonjëherë që të kenë lëshuar urdhra
19 edhe persona të tjerë në emrin tuaj?

20 PË. Po, ka ndodhur.

21 PY. A ka ndodhur ndonjë rast kur të është dashur ta ndryshosh
22 apo ta anulosh një urdhër që ka dalë në emrin tuaj?

23 PË. Në -- nuk më kujtohet.

24 PY. A ka pasur raste kur për shkak të luftimeve në terren,
25 ishte e pamundur të respektoheshin apo të zbatoheshin urdhrat?

1 PË. Po, është e saktë.

2 PY. Ju personalisht, u jeni bindur të gjitha urdhrave që mund
3 t'u bindeshit?

4 PË. Varet. Ka mundësi që ne -- që s' -- nuk e kam ditë. Është
5 -- varet çfarë konteksti ose çfarë rrethanash kanë qenë më
6 herët.

7 PY. Po flasim për urdhra që mundeshit t'u bindeshit. I lemë
8 mënjane urdhrat që nuk ju -- nuk i zbatonit dot. Por, a e keni
9 zbatuar ju të gjithë urdhrat dhe kur ishte e mundshme që t'i
10 zbatonit këto urdhra?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
13 Mund t'i përgjigjeni.

14 DËSHMITARI: Po, besoj që po. Në përgjithësi s' -- rreth
15 organizimit të zonës operative të Drenicës. Unë i kam respektu
16 urdhrat dhe ato -- organigramën jam mundu ta -- që kanë ardh
17 prej Shtabit të Përgjithshëm.

18 Z. HALLING: [Përkthim]

19 PY. Flasim për Shtabin e Përgjithshëm, për ju, si komandanti
20 i zonës së Drenicës, ishte e mundur që ju të lëshonit urdhër
21 për Shtabin e Përgjithshëm?

22 PË. Jo, në këtë nivel është e pamundur që të lëshoj një
23 urdhër ndaj Shtabit të Përgjithshëm.

24 PY. Tani dua të shohim disa dokumente që lidhen me punimet në
25 zonën e Drenicës dhe që e keni diskutuar në seancën

1 përgatitore por edhe në disa deklarata që keni dhënë më
2 përpara.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Fillojmë me provën P139, ta shohim
4 në ekran në anglisht dhe në shqip.

5 PY. Dëshmitar, më herët po flisnim për njësitin special të
6 Jahir Demakut dhe unë pyetjet fillimisht do t'i kem për këtë
7 çështje. Po presim fillimisht të dalin dokumentet në ekran.

8 Ju mund ta shihni, thotë, data është 9 maj i vitit 1998,
9 "Plan program i përgatitjes për njësitin special - komando"
10 dhe ka disa pika këtu, ku te pika 1 thuhet:

11 "Çdo komandant është i obliguar që njësinë e vet në zonën
12 luftarake ta njoftojë për përgatitjet e njësisë speciale -
13 komando".

14 Më pas, te 7, thuhet:

15 "Për çdo kandidat që pranohet në njësinë speciale,
16 përgjegjësinë e mban komandanti i zonës."

17 9-a thotë:

18 "Fillimi i ushtrimeve për njësinë speciale fillon më
19 datën 11 maj të vitit 1998".

20 Dëshmitar, ju thatë në shënimin përgatitor, që nuk është
21 nënshkrimi juaj dhe nuk është as shkrimi juaj, por ama a është
22 ky një dokument që është përdorur nga UÇK-ja në zonën e
23 Drenicës?

24 PË. Mund të jetë, dhe mund, besoj që po.

25 PY. Po pse besoni ju që është?

1 PË. Sepse unë vetë disa herë i kam leshu disa udhëzime për
2 njësitet. Po ky s'po më kujtohet që e kam leshu, po ndoshta
3 është i ngjashëm edhe me disa të tjerë që unë, në kuadër të
4 përgatitjeve ushtarake, ose të brigadave, unë kam lëshu
5 udhëzime ose kam -- edhe me gojë edhe me shkrim.

6 PY. Sa i takon këtij njësiti special, kjo që thuhet në këtë
7 dokument, a përputhet me diskutimet që keni pasur ju për këtë
8 njësit special në maj të vitit 1998?

9 PË. Me kë unë këtë diskutim, nuk e di në -- për cil -- cilin
10 diskutim në maj të vitit 1998?

11 PY. Në fakt kjo ishte pyetje që unë e kisha për ju. Në zonën
12 tuaj, a keni folur ju për një njësit special në këtë periudhë
13 kohore dhe që ky bisedim që të keni pasur ju, të jetë i
14 ngjashëm me pikat që shohim ne në këtë dokument? Për këto
15 pika, domethënë.

16 PË. Unë bashkë me komandantët e brigadave dhe me shefin e
17 shtabit të zonës, me oficerët e zonës, jemi mundu sa më shumë
18 që t'i përgatisim njësitet. Në kuadër të asajna është edhe kjo
19 ndoshta që shkruhet këtu dhe që është për njësitet speciale ose
20 për Brigadën 111.

21 PY. Kur keni përgatituri këtë plan, ose keni bashkëpunuar për
22 këtë plan, bisedimet janë mbajtur në Likovc?

23 PË. Faktikisht bisedimet kanë ndryshu. Varet prej kohës së
24 cilës -- së cilës periudhë. Por megjithatë, janë mbajtur në
25 Likovc edhe në vend tjetër.

1 PY. Po. Data është 9 maj e vitit 1998. Ju keni qenë në Likovc
2 kur është leshu ky dokument?

3 PË. Besoj që në Likovc.

4 PY. Pra, i takon që edhe diskutimet, bisedimet, kanë ndodhur
5 në Likovc atëherë?

6 PË. Ka mundësi. Nuk -- s'jam i sigurt po ka mundësi që në
7 Likovc.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tek anglishtja s'keni datën.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Duhet shkuar në -- është në krye -
10 - është në krye të faqes.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është në
12 fund?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Jo është në krye të faqes.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sepse shqipja e ka edhe në
15 fund të faqes.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Në anglisht është vetëm lart, në
17 krye të faqes.

18 Faleminderit.

19 PY. Dëshmitar, ndërkohë që e heqim dokumentin nga ekrani, do
20 shohim që ka edhe një dokument, ose më saktë është bërë edhe
21 emërimi i Jahir Demakut në 27 gusht të vitit 1998. Kjo është
22 diçka që e keni diskutuar me ish-Tribunalin e Jugosllavisë.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Ndërkohë vendosim provën P120 në
24 ekran ju lutem që ta shohim së bashku. Na nevojitet faqja e
25 parë në anglisht dhe në shqip, U000-8292 -- 12.

1 PY. Dëshmitar, shihni ballinën ju lutem dhe na thoni a është
2 nënshkrimi jua j në të majtë të dokumentit?

3 PË. Po, e saktë.

4 PY. A është vërtetë plan programi i aftësimit të njësitit
5 special "Tigrat e Zinj" ky, për zonën e Drenicës?

6 PË. Po.

7 PY. Këtu shohim edhe nënshkrimin e Afrim Shurecit, poshtë.
8 Kush është ky person?

9 PË. Ka qenë shef i operativës, a më duket, ose shefi i
10 trajnimit të Brigadës 111.

11 PY. Tani shkojmë në faqen e fundit, U000-8219. Shënimet në
12 fund të programit, ku thuhet:

13 "Mosrealizimi i këtij plani justifikohet vetëm në raste
14 të jashtëzakonshme lufte apo imponimi të situatës."

15 Dhe thuhet këtu "Plan-programin SH.O.F Kemal Shokiri."

16 [Sipas përkthimit] E ka përgatitur Kemal Shekiri -- Shaqiri.

17 Kush është Kemail Shaqiri?

18 PË. Kemal Shaqiri është oficeri i karrierës dhe ka qenë shefi
19 i Shtabit në zonën operative të Drenicës.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të nxjerrë në
22 ekran provën materiale P156, në anglisht dhe në shqip.

23 PY. Dëshmitar, dokumenti që sapo pamë kishte edhe periudhën e
24 trajnimit, e aftësimit, nga 1 deri në 15 shtator të vitit
25 1998. Dokumenti që do shohim tani në ekran është pak më vonë

1 në periudhë kohore. është data 22 shtator e vitit 1998 dhe
2 është komunikata 54, dhe thuhet në një pikë:

3 "Luftimet e përditshme janë do -- ka pasur luftime të
4 përditshme në zonën e Drenicës. Njësitë jonë special në Likovc
5 e Prekaz, ka pasur humbje -- i ka shkaktuar, më falni, humbje
6 forcave armike çdo ditë."

7 Tani, shohim datën e komunikatës dhe na thoni nëse ky
8 njësit special i Drenicës ka qenë vërtetë aktiv në Likovc, në
9 Prekaz, në datën 22 shtator të vitit 1998?
10 PË. Në 22 shtator nuk e di a ka -- a është e saktë, por më 22
11 shtator ka qenë luftime të ashpra jo vetëm në Prekaz dhe pjesë
12 të tjera, por forcat serbe kanë depërtuar edhe në Likovc dhe
13 në fshatrat rreth Likovcit. Dhe njësitë special nuk ka mujt të
14 jetë në çdo vend por është gjithë -- edhe ky njësit dhe të
15 gjitha njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës jemi përballu
16 dhe jemi -- kemi pas luftime të ndryshme nëpër pozicione -- në
17 vende të ndryshme. Në tërë Drenicën.

18 PY. Faleminderit. Tani do shohim disa dokumente që i kemi
19 diskutuar në seancën përgatitore që ishte koha e të korrave në
20 zonën e Drenicës.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Fillojmë me provën 142 në ekran,
22 ju lutem, në anglisht dhe në shqip.

23 PY. Dëshmitar, këtu thuhet:

24 "Kërkesë

25 "Kërkojmë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së që për

1 nevoja të Shtabit Operativ të Drenicës si dhe për fushatën e
2 korrje-shirjeve, të na lejohen mjete në të holla, me blerë
3 prej:"

4 Dhe ka një listë, dhe në fund në të majtë ka një
5 nënshkrimi, pyetja ime e parë është kjo: Nënshkrimi në
6 dokument, a është i juaji?

7 PË. Po.

8 PY. A ja keni bërë ju këtë kërkesë Shtabit të Përgjithshëm?

9 PË. Këtu shihet që ju kam drejtu Shtabit të Përgjithshëm me
10 këtë kërkesë dhe nuk e di a është shku në Shtabin e
11 Përgjithshëm, por e di që ne kemi pas vështirësi dhe
12 interesimi ka qenë shumë i madh, i imi dhe i të gjithëve, e i
13 të tjerëve në zonën operative të Drenicës që të kryhen
14 korrjet, për arsye se kishin mbetur pa korr dhe shumë
15 popullata zhvendosur nëpër zona të brendshme, jashtë
16 luftimeve. Jam munduar me ua shpjeguar edhe juve, edhe për të
17 gjithë të pranishmit. Ka qenë edhe një pjesë tjetër e cila
18 është dasht që të mobilizohet dhe të, domethënë, të korrin,
19 dhe t'i vijjnë në ndihmë popullatës civile. Po, është
20 nënshkrimi jem, dhe iu kam drejtu Shtabit të Përgjithshëm me
21 këtë kërkesë.

22 PY. Serbët që kërcënonin në këtë periudhë të korrj -- të
23 korrjeve dhe të shirjeve, a mund të ndikonte kjo gjë pastaj në
24 ushqimet që kishte UÇK-ja, në furnizimet me ushqim?

25 PË. Jo, unë ia kam shpjegu jo vetëm që, domethënë, UÇK-ja,

1 por në përgjithësi popullata civile bashkë me të gjithë normal
2 që ka pas vështirësi në ushqim.

3 PY. E kuptoj. A ju kujtohet nëse i keni marrë burimet që keni
4 kërkuar këtu?

5 PË. Nuk më kujtohet. Nuk e di saktë. Besoj që jo, por nuk më
6 kujtohet.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Tani shohim provën P131.

8 PY. Dëshmitar, dokumenti që pamë më herët kishte datën 6
9 korrik, 1998. Ky ka datën 14 korrik të vitit 1998 dhe flet:

10 "Komunikatë

11 "Lidhur me korrje-shirjen e grurit."

12 Dhe ku thuhet që:

13 "Bujqit duhet t'i japin -- për nevojat e UÇK-së bujqit
14 obligohen të ndajnë 10 [Sipas përkthimit] kilogram për hektarë
15 dhe autokombanierët janë të obliguar të japin 10 kg për 1
16 hektarë grurë."

17 Dhe është kjo e njëjta gjë që keni diskutuar ju, e njëjta
18 çështje për korrje-shirje në dëshminë që keni dhënë për ish-
19 Tribunalin e Jugosllavisë?

20 PË. Po, është e njëjta.

21 PY. Këtë e ka nënshkruar Shaban Shala në emrin tuaj?

22 PË. Po, shihet që është nënshkrimi i Shaban Shalës.

23 PY. Faleminderit.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Tani flasim për aftësimin, po në
25 terma të përgjithshëm. Shohim provën P126.

1 PY. Dëshmitar, data këtu është 29 korrik, e vitit 1998. Është
2 një urdhëresë -- është një urdhëresë për formimin e një kursi
3 për kandidatët për komandatë për kompani, toga. Shihni te pika
4 3 që kursi është parashikuar të fillojë më 27 korrik të vitit
5 1998 deri më 10 gusht të vitit 1998. Në orën 5 [Sipas
6 përkthimit] emërohen oficerë Xhemal Bejta, si komandant i
7 kursit. Më poshtë thuhet, Shaban Dragaj, Agron Zeqirti, te
8 pika 8, Iljaz Kodra.

9 Dëshmitar, unë e kuptoj që nuk është as shkrimi juaj, as
10 nënshkrimi juaj. Por në zonën tuaj, a është organizuar ndonjë
11 kurs aftësimi për periudhën 27 korrik-10 gusht e vitit 1998,
12 siç thuhet këtu?

13 PË. Përderisa s'është -- ne e kemi diskutu, as shkrimi im, as
14 nënshkrimi, por jam mundu që, po, të organizoj kurse të tilla
15 kur unë kam pas mundësi dhe kur unë nuk kam luftime dhe jam --
16 jam mundu të ri organizoj me brigadat në zonën operative të
17 Drenicës.

18 PY. Personat që janë emëruar për kursin që përmendet në këtë
19 dokument, a janë të njëjtët persona që zakonisht urdhëroheshin
20 për të kryer kurse të këtij lloji?

21 PË. Po, kanë pas -- është, domethënë, Shaban Dragaj, Kemal
22 Shaqiri dhe Xhamal Bejta, kanë qenë në Shtabin Operativ të
23 zonës operative të Drenicës, dhe këta kanë pasur mundësi që të
24 shiqojnë dhe të lëshojnë kësi urdhnesa për pjesëtarët.

25 PY. Ta mbarojmë dhe me emrat e tjerë në dokument që nuk i

- 1 kemi përmendur -- që nuk i përmendët. Agron Zeqiri kush është?
- 2 PË. Nuk e njoh edhe përveç Shaban Dragaj, Agronin nuk e njoh.
- 3 PY. Po Hazir Lushatkun?
- 4 PË. As Hazir Lushtakun nuk po më -- nuk më kujtohet si emër.
- 5 Ndoshta ka qenë në nivelin më të ulët të shërbimit, po nuk më
- 6 kujtohen si emra.
- 7 PY. Ilaz Kodrën e keni përmendur edhe më herët, por na e
- 8 thoni edhe një herë. Ju lutem, çfarë roli ka pasur Ilaz Kodra?
- 9 PË. Pas rënies heroike të komandantit të Fehmi Lladrovci, e
- 10 ka zëvendësu Ilaz Kodra si komandant i Brigadës 114, e ka qenë
- 11 komandanti i Brigadës 114.
- 12 PY. keni ndonjë arsye ta kontestoni faktin që ky dokument në
- 13 fakt ka qenë një dokument, ka qenë një urdhëresë për kurs
- 14 aftësimi në zonën e Drenicës?
- 15 PË. Jo, nuk e kam asnjë arsye, dhe ka mujt me qenë, edhe ne
- 16 jemi munduar që t'i -- herë pas herë të mbajmë kurse të tilla.
- 17 PY. Faleminderit. Data është 29 korrik e vitit 1998.
- 18 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të doja të shihnim në
- 19 ekran dokumentin 096746 deri në 096747, dhe do të shohim
- 20 ballinën.
- 21 PY. Dëshmitar, këtu thuhet data 1 gusht e vitit 1998, thuhet
- 22 "Orari ditor i punës", ka disa aktivitete këtu dhe orët
- 23 përkatëse. Atëherë, e kuptoj që nuk e keni shkruar ju dhe nuk
- 24 është nënshkrimi juaj ky, por a mund të na thoni në qoftë se
- 25 ky ishte programi i përditshëm, i zakonshëm për një ushtar që

1 ishte pjesë e UÇK-së atëherë?

2 PË. Jo, program -- ky është një orar ditor i kursantëve. Ata
3 të cilët do të duheshin të merrnin pjesë në këtë kurs, ose që
4 kanë mbajtur një kurs të tillë dhe ky është një orar ditor i
5 punës së një kursanti, të cilit është dashtë të vijojë kursi,
6 por jo për të gjithë pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të
7 Kosovës -- të zon -- të Ushtria Çlirimtare të Kosovës në zonë,
8 por nëpër një orar ditor i një kursi.

9 PY. E kuptoj. Njëra prej zërave të fundit të shkruara këtu në
10 tabelë, është dëgjimi i lajmeve. Në këtë periudhë, se këtu
11 "Leximi i Lajmeve" ose "Dëgjimi i Lajmeve" nga ora 6.35-7.00
12 pasdite. Më 1 gusht të vitit 1999 [Sipas përkthimit], çfarë
13 lloj lajmesh dëgjoheshin?

14 PË. Këtu është me rëndësi që -- si e ka parapa oficer -- ky
15 programin ditor, dhe në kuadër të këtij programi ditor të një
16 kursanti, ka paraparë edhe -- edhe, domethënë, shiqimin e
17 televizorit. Vlen të theksohet se në këtë periudhë, ose në
18 këtë kohë, përveç televizionit shqiptar, i cili ka qenë dy orë
19 kushtuar vetëm për Kosovën, nuk ka pas një median tjetër të
20 cilët pjesëtarët në gjuhën shqipe, ose në -- kur flas për
21 televizionet, si radio televizioni i Prishtinës por edhe të
22 Beogradit, kanë qenë të gjitha në shërbim të forcave serbe dhe
23 të kësaj kohe. Kurse këtu është -- ju ka drejtu kursantëve që
24 me i pa programet, domethënë programet i cili është transmetu
25 në atë kohë në Shqipëri. Domethënë, që iu ka kushtu dy orë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 113

1 çështjes së Kosovës.

2 PY. Faleminderit.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky është
4 dokumenti i parë i cili nuk është pranuar tërësisht i gjithi
5 si provë gjyqësore në këtë sekuencë. Do kërkonim që të
6 pranohej në provë gjyqësore ky dokument i parë në kuadrin e
7 dokumentit të mëparshëm dhe më konkretisht bëhet fjalë për
8 faqet 096746 deri në 096747.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
10 kundërshtim nga palët? Përderisa nuk ka kundërshtim nga palët,
11 dokumenti 096746 deri në 096747 pranohet në prove gjyqësore.

12 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
13 t'i caktohet numri i provës P02033. Ju lutem më konfirmoni
14 klasifikimin.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Klasifikojeni publik.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
17 Riklasifikojeni si publik.

18 Z. HALLING: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, dua t'iu tregoj një urdhër të fundit.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares
21 që të paraqesë në ekran dokument in P130.

22 PY. Ky dokument thotë që është një "Urdhër për 45 baza".

23 Thotë që:

24 "Personat -- civilët jo të uniformizuar duhet të
25 mobilizohen dhe duhet të mblidhen, pavarësisht kësaj. Ndërkohë

1 që më pas thuhet që "duhet që në mënyrë urgjente të fillojnë
2 që të përforcojnë pozicionet e zjarrit, bunkerët" dhe ata
3 udhëzohen "sipas udhëzimeve të komandantit".

4 A mund të na thoni, Dëshmitar, nënshkrimi në këtë urdhër
5 a është i juaji apo jo?

6 PË. Po, është i imi, shihet që është i imi.

7 PY. Ky është një urdhër që ju e keni nxjerrë diku nga 30
8 qershori, i vitit -- korriku, më falni, i vitit 1999 [Sipas
9 përkthimit], Dëshmitar?

10 PË. Besoj që po.

11 PY. Çfarë ju bëri ju që të nxirrnit një urdhër për të
12 mobilizuar civilët? Domethënë, çfarë po ndodhte në këtë
13 periudhë, rreth 30 korrikut të vitit 1998 që ju detyroi juve,
14 ose ju bëri, ju shtyu juve që të nxirrnit këtë urdhër,
15 Dëshmitar?

16 PË. Është shumë e thjeshtë. Edhe do mundohna që unë ta -- tua
17 -- ta shpjegoj. Jam mundu edhe -- edhe besoj që edhe juve me
18 ua shpjegu.

19 Atëherë, pas 5 marsit gjithmonë ka pas luftime në vende
20 të ndryshme dhe të zonës operative të Drenicës. Atëherë kanë
21 filluar edhe granatimet dhe -- nëpër pozicione dhe nëpër
22 brendësi të fshatrave të ndryshëm, dhe rrezikshmëria a kanë
23 shumë e lartë edhe ndaj civilëve, edhe ndaj pjesëtarëve të
24 cilët kanë qenë në front. Por më shumë ka qenë për mobilizimin
25 dhe kujdesin dhe ruajtjen e popullatës dhe të civilëve të

1 cilët -- që të hyjnë në strehimore dhe të kenë një mburojë
2 prej granatimeve të ndryshme.

3 PY. Faleminderit. Dëshmitar, do ta lëmë temën e vendimeve,
4 megjithatë dua që të tregoj një tjetër dokument.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Është një dokument i cili po ashtu
6 pranuar në provë gjyqësore. Për procesverbal, bëhet fjalë për
7 provën P760-ET.2 në anglisht, dhe kam përshtypjen që në
8 versionin në shqip besoj do jetë P760. Në qoftë se do e
9 ndihmoja sekretaren, faqja ERN e faqes është 076603 deri në
10 076603.

11 PY. Dëshmitar, dokumenti që keni përpara në ekran e kemi parë
12 edhe në seancën përgatitore. Thuhet "Reagim" në fillim fare
13 dhe thuhet që duam që të informojmë publikun që "Gani Geci nuk
14 është tradhtar" dhe:

15 "E kundërshtojmë komunikatën përkatëse, që është
16 komunikata 59" dhe pastaj jepet, jepen disa nënshkrime.

17 Dua t'iu pyes këtë pyetje, Dëshmitar. A është ky një
18 dokument në të cilin keni qenë ju i përfshirë dhe siç e
19 lexova, ky është një dokument ku jepen argumente që Gani Gaci
20 -- Geci nuk ka qenë tradhtar?

21 PË. Po, është e saktë, edhe është nënshkrimi im, dhe emri im
22 në këtë reagim.

23 PY. Sa për procesverbal, për të qenë i qartë, këtu në
24 rreshtin e dytë, këtu është nënshkrimi juaj, Dëshmitar?

25 PË. Po. I saktë.

1 PY. A mund të shpjegoni arsyen e pse ishte i nevojshëm ky
2 dokument? Pse ishte e nevojshme që të krijohej ky dokument?

3 PË. Për arsye të një interviste të -- edhe të -- të është
4 shfaq në televizion. Në këtë kohë ne e kemi parë të arsyeshme
5 që të kundër-reagojmë.

6 PY. Çfarë thoshte, për çfarë kishte të bënte fjalë kjo
7 intervistë që u transmetua në televizion?

8 PË. Kryesisht shihet edhe teksti që -- një kundër-reagim që
9 Gani Geci nuk ka qenë -- nuk i ka prirë ofensivës dhe nuk ka
10 qenë tradhtar, si --

11 PY. E qartë. Faleminderit, Dëshmitar.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga
13 ekrani.

14 PY. Kam disa pyetje të tjera shtesë lidhur me nofka, me disa
15 nofka, por para se të vazhdojmë më tej, gjatë luftës çfarë
16 nofke ka pasur Hashim Thaçi, Dëshmitar?

17 PË. Nuk ka qenë publike atëherë, dhe e dija se -- nofkën
18 Gjarpri.

19 PY. Po nofka e Kadri Veselit cila ka qenë?

20 PË. Nuk jam i sigurt, nuk e di, por më duket se ka qenë Luli,
21 por prapë, nuk jam i sigurt -- i saktë.

22 PY. Po nofka e Rexhep Selimit, cila ka qenë?

23 PË. Ka qenë Dhjetëshi.

24 PY. Tani të flasim për vitin 1999. A jeni në dijeni të një
25 shkëmbimi të të burgosurve serbë me të burgosurve shqiptarë në

1 janar të vitit 1999, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. Sa serbë janë kapur asokohe nga UÇK-ja?

4 PY. Nuk e di, më duket një -- një skuadër. Nuk e di numrin a
5 ka qenë nëntë apo dhjetë.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se
7 më lejoni, dua që t'i rifreskoj kujtesën Dëshmitarit në
8 paragrafin 40 të Shënimit Përgatitor 2.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
10 vazhdoni.

11 Z. HALLING: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, juve thoni në këtë paragraf të shënimeve
13 përgatitor, që:

14 "Ka pasur një çështje, apo një problem të vazhdueshëm me
15 tetë ushtarë serbë, të cilët ishin kapur në zonën e Shalës".

16 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po, e saktë. Se nuk e di -- prapë nuk e di numrin e
18 saktë, dhe atë -- besoj që tetë.

19 PY. Takimi i Shtabit të Përgjithshëm me ndërkombëtarët, a
20 kishte të bënte me një shkëmbim të mundshëm të këtyre
21 personave?

22 PË. Ne kufirin shqiptar ka hyrë në Kosovë një grup i prirë
23 nga Mujë Krasniqi, domethënë komandanti Mujë Krasniqi, ka ra
24 në pritë dhe janë vra shumë ushtarë aty dhe disa prej tyre
25 janë zënë rob, dhe shkëmbimi i këtyre ushtarëve ka qenë me

1 këtë pjesën të cilët kanë qenë -- janë zënë rob në këtë
2 betejë. Domethënë, ndërrimi është bërë me ta.

3 PY. Mbledhja e Shtabit të Përgjithshëm me ndërkombëtarët, a
4 kishte të bënte me këtë shkëmbim? Domethënë, a u bë kjo
5 mbledhje për të diskutuar për këtë shkëmbim, Dëshmitar?

6 PË. Besoj që po. Në nivel të Shtabit të Përgjithshëm nuk
7 besoj që -- nuk e di kush i ka udhëheqë, por e di që është
8 bisedu shumë që të bëhet ky shkëmbim i të burgosurve.

9 PY. Kur u ra dakord për shkëmbimin, pjesë e kësaj, a ndodhi
10 në Likovc?

11 PË. Po, dorëzimi i ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të
12 Kosovës është bërë në Likovc. Kurse i ushtarëve serbë, është
13 bërë në diku në Shalë, nuk e di, nuk -- s'jam i saktë. Kur u
14 bë shkëmbimi është -- e di që pjesa e ushtarëve të Ushtrisë
15 Çlirimtare të Kosovës kanë ardh në Likovc [E pakuptueshme]
16 Likovc.

17 PY. Dëshmitar, sikurse e kam kuptuar nga seanca përgatitore,
18 ju nuk keni qenë i informuar për një gjeneral [Sipas
19 përkthimit] norvegjez, të quajtur Pal Guenstain, [Përkthyesja:
20 Siç e tha shqiptimin Prokurori].

21 PË. Po, e saktë

22 PY. Gazetar norvegjez.

23 PË. Po, e saktë, nuk më kanë informu.

24 PY. Z. Refsdal ka shkruar një libër, disa faqe ua treguam
25 gjatë seancës përgatitore. Megjithatë, tani dua që t'iu pyes

1 lidhur me disa faqe të tjera për të parë seç dini ju.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë arsye do i kërkoj
3 Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin SPOE00209434 deri
4 në 00209512 në versionet në shqip dhe në anglisht. Ndërkohë që
5 faqja për të cilën jam i interesuar është SPOE00209482.

6 PY. Sa për t'iu orientuar, Dëshmitar, drejtë fundit të faqes
7 në anglisht thuhet që:

8 "Nuk kanë kaluar më shumë se disa javë që jam takuar me
9 Lulin dhe Gjarprin në një restorant në Bruksel".

10 Kjo është thjeshtë sa për të të krijuar idenë e asaj
11 çfarë do shpjegohet më tej në faqen pasuese në shqip dhe në
12 anglisht.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe e kam fjalën konkretisht për
14 SPOE00249483 [Sipas përkthimit].

15 PY. Gazetari Refsdal shkruan si më poshtë sa i takon këtij
16 takimi:

17 "'Ju të dy e dini se Norvegjia është në krye të OSBE-së
18 këtë vit', tash me një ton didaktik. 'Ministri i Jashtëm
19 Vollebek është në Shqipëri, do të shkojë në Kosovë pas tre
20 ditësh.'

21 "Ndala për dy a tre sekonda për të lënë të kuptohet që do
22 të thosha diçka të rëndësishme.

23 "'A nuk do të ishte më mirë që ai të takohej me UÇK-në
24 atje?'

25 "Ata panë njëri-tjetrin dhe shkëmbyen nja dy fjalë në

1 shqip. pastaj Gjarpri u ngrit, nxori telefonin mobil dhe ja
2 ktheu shpinën për të biseduar.

3 "Ai mund të shkojë në Likovc. Ne do të sigurojmë që të
4 takohet me dikë nga udhëheqja', tha ai dhe u ul përsëri në
5 tavolinë".

6 Dëshmitar, pyetja që kam për ju tani është kjo: A jeni në
7 dijeni që Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli kanë organizuar një
8 takim nga jashtë shteti me Ministrin e Jashtëm Vollebaek, dhe
9 që ky, pra, Ministri i Jashtëm, do bënte një takim në Likovc?
10 A jeni në dijeni të kësaj, Dëshmitar?

11 PË. Jo, nuk jam në dijeni.

12 PY. Dua që t'iu pyes edhe lidhur me një pjesë tjetër pak më
13 poshtë. Më pas gazetari thotë:

14 "Dy ditët në vijim unë shërbeva si ndërmjetëm në një
15 kanal të çuditshëm komunikimi midis UÇK-së dhe delegacionit
16 norvegjez. Gjarpri dhe Luli biseduan me UÇK-në në Kosovë dhe
17 pastaj më telefonuan mua. Unë i telefonova kontaktit tim, i
18 cili nga ana e tij foli me Vollebaek. Megjithatë se delegacioni
19 ndodhej në Ballkan, nuk mund të thosha gjithçka haptazi në
20 telefon. Prandaj m'u desh të kontaktoja seksionin e shifrës në
21 Ministrinë të Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe ata sollën
22 dikë tjetër, i cili nga ana e tij i dërgoi një mesazh të
23 koduar delegacionit.

24 "Ditën që Vollebaek udhëtoi për në Ballkan, një grup prej
25 tetë ushtarësh serbë kaluan në rrugën e gabuar dhe u kapën

1 robër ngas UÇK-ja. Autoritetet serbe kërcënuan se do të
2 rifillonin luftën nëse ushtarët nuk do të liroheshin dhe
3 çështja e pengjeve e hodhi komplet në hije vizitën e Ministrit
4 të Jashtëm. Ditën e fundit të vizitës, kur isha ulur duke ulur
5 duke ngrënë, mora një telefonatë nga kontakti im.”

6 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo që: A jeni ju
7 në dijeni lidhur me atë çfarë ka bërë UÇK-ja, domethënë me
8 kapjen e tetë ushtarëve serbë?

9 PË. Jo, nuk jam në dijeni. Jam kam shpjegu edhe --

10 PY. -- dhe a jeni në dijeni të faktit që Ministri i Jashtëm
11 Vollebaek ka pasur një takim me UÇK-në lidhur me këtë tetë
12 serbë?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Tani, lidhur me atë çfarë na
14 shpjeguat pak më herët, do kërkoja që të shikonim provën P182.
15 Do fillojmë në faqen SPOE00226369, që është faqja e parë.

16 PY. Dëshmitar, me ç’ë kam kuptuar unë, këto shënime ju nuk
17 është se i keni parë përpara seancës përgatitore. A është e
18 vërtetë kjo?

19 PË. Po, e vërtetë.

20 PY. Këtu thuhet 11 janar i vitit 1999. Likovc, FL, pastaj
21 vijon më tej:

22 “Ju urojmë mirëseardhjen dhe shprehim gatishmërinë për
23 t’u takuar me juve. Në emër të UÇK-së, ju përshëndesim. Ju
24 falënderojmë juve dhe në veçanti përshëndesim Norvegjinë dhe
25 Ministrin tuaj.”

1 Tani le të kalojmë te faqja tjetër e të njëjtit dokument.

2 Më tej thuhet:

3 "Ky është takim konsultativ. Qëndrimet e këtij tubimi do
4 t'i infromo -- do t'i përcillen Shtabit të Përgjithshëm.
5 Situata po keqë -- përkeqësohet dhe rreziko -- rreziku po
6 rritet. Kjo situatë aktualisht është e izoluar por e
7 tensionuar për shkak të nëntë -- të tetë ushtarëve serbe."

8 Në këtë periudhë në fund të vitit 1998 dhe në fillim të
9 vitit 1999, a ka pasur një situatë të axhituar ose të
10 tensionuar, si rezultat e kapjes është këtyre tetë ushtarëve
11 serbë nga UÇK-ja?

12 PË. Jo, nuk më kujtohet një gjë e tillë. Situata [E
13 pakuptueshme] kam pas çdo herë në Drenicë, kurse këta
14 pjesëtarë janë xanë -- ranë ndesh në zonën e Shalës, jo në
15 zonën e Drenicës.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të kalojmë në faqen
17 SPOE00226372.

18 PY. Këtu thuhet:

19 "Ministri Vollebaek kërkoi në mënyrë urgjente dhe me ton
20 që UÇK-ja të kontribuonte që të ulte tensionin përmes lirimit
21 të menjëhershëm të tetë ushtarëve. Ky do të ishte një aktakuzë
22 humanitar. Z. Vollebaek besonte se lirimi i ushtarëve mund të
23 krijonte një moment të ri për një zgjidhje politike."

24 A keni ndonjë arsye për të kundërshtuar që ajo që çfarë
25 shikoni këtu në ekran janë shënimet e UÇK-së për takimin që ka

1 pasur me Ministrin norvegjez Vollebaek në janar të vitit 1999,
2 Dëshmitar?

3 PË. E para, ky nuk është as shkrimi imi, as nuk e di kush e
4 ka shkru. E dyta, e di që ka pas takime në nivel të Shtabit të
5 Përgjithshëm me diplomatë të ndryshëm dhe me politikanë të
6 ndryshëm, por sa i përket këtij takimi, unë nuk jam në dijeni
7 dhe nuk e di a ka ndodh ky takim apo nuk ka ndodh.

8 Por, përderisa shihet që është mbajtur një, një shkrim ose
9 një procesverbal ose -- nuk mund -- mund të jetë që ky takim
10 ka ndodh, po unë nuk jam në dijeni.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di në
12 qoftë se kjo mund të jetë në papajtueshmëri, megjithatë do të
13 doja që ta konsultoja me dëshmitarin lidhur me një paragraf në
14 seancën përgatitore. Më konkretisht, në paragrafin 40 të
15 Shënimit Përgatitor numër 2.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, ju thatë në seancë përgatitore që nuk ju
19 kujtohet një takim i kësaj natyre të ketë ndodhur më 11 janar
20 të vitit 1999, por që nuk keni arsye për të kundërshtuar që ka
21 ndodhur një takim i tillë, dhe që janë diskutuar tema të cilat
22 janë përshkruar në të. Ky -- kjo thuhet në shënime.

23 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. E saktë, dhe prapë, prapë po mundohem të shpjegoj të
25 njëjtën gjë.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më përpara ne
2 kemi argumentuar që e gjithë ky dokument, domethënë që ka të
3 bëjë me dëshminë -- me këtë dokument të gazetarit, duhet që të
4 pranohet si e tërë. Neve synojmë që të kërkojmë pranimin e të
5 gjithë dokumentit por këtë do ta bëjmë me një dokument që do
6 t'ua paraqesim më vonë. Aktualisht kërkojmë që faqet që u
7 diskutuan me dëshmitarin, të mund t'i shtohen provës
8 ekzistuese P1449. E kam fjalën konkretisht për faqen
9 SPOE00209482 deri në SPOE00209483 dhe këtë do t'i shtohen
10 provës P1449.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
12 kundërshtim?

13 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe unë kam kundërshtim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kush do ta
16 marrë fjalon?

17 Z. DIXON: [Përkthim] Po, ne kundërshtojmë se dëshmitari
18 nuk pati mundësi ose tha që nuk i kujtohet ose nuk identifikoi
19 asgjë nga informacioni i dhënë në këto faqe. Ai nuk tha asgjë
20 të re sa i takon përvojës së vet se çfarë i kujtohet atij. Ky
21 është një përshkrim i cili është dhënë nga dikush dhe është
22 pjesë e një libri, dhe në qoftë se Prokuroria është e
23 interesuar mund ta thërrasë këtë person që ka shkruar librin
24 dhe të japë dëshmi lidhur me atë të cilën Prokuroria pyeti
25 dëshmitarin. Pra, dëshmitari nuk ka lidhje fare me këtë botim,

1 me këtë libër fare, kështu që nuk është mënyrë e qartë për të
2 kërkuar pranimin e këtij dokumenti në prova. Pra, sikurse e
3 tha edhe Prokurori, Prokurori mund të kërkojë drejtpërdrejt
4 jo përmes dëshmisë së dëshmitarit, por gjithsesi, domethënë
5 nuk jemi, nuk jemi dakord që ky dokument të mund të pranohet.
6 Megjithatë mund ta caktoni -- mund të caktoni një numër
7 provizor prove.

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Edhe ne i bashkohemi këtij
9 kundërshtimi.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe unë i bashkohem parashtrimeve
11 të palëve të tjera, dhe do shtoja që dëshmitari ka mësuar
12 lidhur me këtë ndërkohë që e ka le -- e lexuar këtë
13 informacion në libër, ndërkohë që nuk di asgjë lidhur me të.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Ne të gjithë përgjigjemi që ky
15 dëshmitar ka shërbyer si një lidhje përmes informacioneve në
16 libër dhe informacionit që është sekuestruar nga Rexhep
17 Selimi. Dhe pavarësisht se dëshmitari nuk mund që të vërtetojë
18 saktësinë e këtyre shënimeve, mendoj që pavarësisht kësaj,
19 përmes përgjigjeve të dhëna nga dëshmitari, demonstrohet
20 relevanca e këtyre faqeve dhe këto faqe kanë vlerë provuese.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, procesverbalet
22 janë pjesë e provave, por çështja që ngrihet këtu është një
23 gazetar i huaj i cili ka regjistruar ngjarjet siç kanë
24 ndodhur, dhe ajo çfarë po themi neve është që nuk ka lidhje
25 fare. Nuk ka fare lidhje midis asaj çfarë thotë ky dëshmitar

1 dhe asaj çfarë ka shkruar gazetari i huaj. Ne parashtrojmë që
2 nuk ka fare lidhje.

3 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe ne i bashkohemi parashtrimin
5 të kolegut. Nuk ka as minimumin e lidhjes midis asaj çfarë ka
6 shkruar gazetari dhe asaj çfarë tha dëshmitari. Nuk përmbushet
7 asnjë kriter minimal i provueshmërisë.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Mendoj që Z.
9 Misetic foli ndërkohë që i kishit hequr kufjet, por mendoj që
10 ajo çfarë tha z. Misetic është e pasqyruar në transkriptim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 [Mikrofoni çaktivizuar].

13 Dokumenti 209 -- 209482 deri në 209483 marrin një numër
14 provizor identifikimi. Ju lutem, caktojini një numër provizor.

15 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
16 t'i shtohen -

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
18 çaktivizuar].

19 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] T'ia shtojmë numrit
20 ekzistues?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, prova P1449
22 është në provë e pranuar gjyqësore. Nuk e di në qoftë se është
23 e mundur që t'i shtohet një faqe që ka numër provizor prove.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i
25 caktojim numër të veçantë tani dhe në qoftë se do ta pranojmë,

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 127

1 atëherë mund t'ia bashkëlidhim provës ekzistuese. Në të
2 kundërtën, do ta heqim fare.

3 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Në këtë rast do të marrë
4 numrin e provës provizore P02034.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
6 çaktivizuar].

7 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e di që ka
8 arritur koha e pushimit ndërkohë që do filloj me një temë të
9 re, kështu që mendoj që është momenti i përshtatshëm tanin.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
11 bëjmë pushim tani për dhjetë minuta. Ju lutem mos flisni me
12 askënd jashtë sallës së gjyqit lidhur me dëshminë tuaj.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
15 pushim deri në orën 15.40.

16 --- Pauza fillon në orën 15.29

17 --- Seanca rifillon në orën 15.40

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
19 sillni dëshmitarin në sallë.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
22 uleni.

23 Fjala është për ju ende.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

25 Për pyetjet e radhës unë do të përdor material që është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 128

1 konfidencial, prandaj do ju lutesha që për këto pyetje të
2 radhës të kalonim në seancë private.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
4 seancë private.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 129

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 130

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 131

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

11 Z. HALLING: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, do shohim një dokument tjetër tani.

13 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të shohim

14 dokumentin SITF00243005 deri në 00243010, faqja SITF00243009.

15 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje lidhur me momentin kur

16 jeni bërë komandant i përgjithshëm i UÇK-së. Dhe do të filloj

17 me diçka që i ka thënë Rexhep Selimi gazetës Zëri.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Faqja 6 tek anglishtja. Ndërsa

19 shqipja më poshtë besoj. Po. Në këtë faqe po shkojmë në fund

20 tek anglishtja.

21 PY. Është pyetja:

22 "A kishte Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së një komandant

23 asokohre?"

24 Dhe Rexhep Selimi në përgjigjen e vet ka thënë kështu:

25 "Edhe pse Sylejman Selimi ishte goxha i rezervuar, modest

1 dhe hezitues, ne e bindëm që ta merrte këtë rolin, të ishte
2 komandanti i UÇK-së. Ai ishte modest, neglizhonte sepse e
3 dinte që ishte një pozitë shumë e lartë kjo, por ne të gjithë
4 bashkëluftëtarët këmbëngulëm që ai ta pranonte. Dhe vendimi i
5 Shtabit të Përgjithshëm ishte unanimit, njëzëri.”

6 Pyetje ime është kjo: Rexhep Selimi a e ka përshkruar
7 saktë mënyrën se si u bëtë ju komandanti i përgjithshëm i UÇK-
8 së?

9 PË. Po, besoj që po.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky është një
11 material tjetër që kemi kërkuar të pranohet përmes mocionit
12 për prova jogojre. Do të bëjmë mocion tjetër pasi të
13 përfundojmë me pyetjet e këtij dëshmitari, por ju lutem për
14 momentin do kërkonim që të pranohej vetëm faqja për të cilën
15 komentoj dëshmitari, edhe fjalë për faqen SITF00243009 të
16 materialit në tërësinë e vet.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
18 kundërshtim?

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Unë nuk e kuptoj atëherë për çfarë
20 duhet bërë mocion për pranimin e provave jogojore, sidoqoftë
21 është e drejta e Prokurorisë. Po unë mendoj që nuk pranohet,
22 nuk mund të justifikohet pranimi i tërë intervistës me dy
23 fjalët që tha dëshmitari.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do pranojmë
25 vetëm këtë faqe. SITF00243009, në faqen 00234 [Sipas

1 përkthimit].

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
3 provës P020305 -- 30 -- 035, më falni.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përmbush
5 kriteret e rregullës 238 [Sipas përkthimit].

6 Z. HALLING: [Përkthim] Klasifikimi mund të jetë publik.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, tani do të shohim provën P228 [Sipas
10 përkthimit], në anglisht edhe në shqip, 227, më falni.

11 Dëshmitar, për kontekst, mesa kuptojmë ne ky është një
12 dokument ku kërkohen nënshkrimet për miratimin e bisedimeve të
13 Rambujesë. Përpara seancës përgatitore a e kishit parë
14 ndonjëherë këtë dokument?

15 PË. Jo.

16 PY. Besoj që është e qartë, po do ua bëj dhe një herë këtë
17 pyetje. A e keni nënshkruar ju këtë dokument?

18 PË. Çoje faqen, nuk po e shoh krejt faqen deri në fund.

19 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të shkojmë më
20 poshtë të shohim firmat?

21 DËSHMITARI: Jo, nuk e kam -- nuk më -- nuk e di për këtë
22 dokument edhe nuk e kam nënshkru unë.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Mund të hiqet nga
24 ekrani.

25 PY. Tani të flasim për Operacionin Shigjeta. Plani për

1 Operacionin Shigjeta kur u miratua?

2 PË. Plani për Operacionin Shigjeta unë si komandant i
3 përgjithshëm e kam nënshkru dhe nuk e di saktë nuk e di në
4 këtë kohë cila është, po unë e kam nënshkru atë planin e
5 Operacionit Shigjeta.

6 PY. Sa kohë ka ndodhur kjo përpara se të hiqeshit nga posti i
7 komandantit të përgjithshëm? Sa kohë përpara?

8 PË. Të nesërmen unë kam propozu që të emërohet në vend timin
9 Agim Çeku.

10 PY. A e kishit takuar ndonjëherë Agim Çekun përpara ditës kur
11 u tërhoqët si komandant i përgjithshëm?

12 PË. Jo, kjo ka qenë takimi i parë me të.

13 PY. Pra, kur propozuat ju që të emërohej Agim Çeku në vendin
14 tuaj të nesërmen, kujt ja bëtë ju këtë propozim? Me cilin
15 person e bëtë këtë bisedë?

16 PË. Ne kemi qenë bashkë, unë e Agimi -- unë e Agimi, ka qenë
17 Hashimi edhe Kadria edhe disa oficerë të tjerë të Shqipërisë.

18 PY. Së pari, a mund të na jepni dhe mbiemrin e këtyre
19 personave që përmendët në përgjigjen pararendëse, ju lutem, që
20 ta kemi për procesverbal?

21 PË. Po. Domethënë, Hashim Thaçi edhe Kadri Veseli, Agim Çeku,
22 unë edhe disa oficerë të Shqipërisë me emra nuk më kujtohen.

23 Ka qenë Spiro Butka -- më fal, edhe dikush tjetër që tash për
24 momentin s'po më kujtohet.

25 PY. Dëshmitar, nuk po flas për të gjithë personat që kanë

1 qenë në atë zonë në atë kohë, por personat që kanë qenë me ju
2 personalisht kur propozuat ju që të bëhej Agim Çeku komandant
3 i përgjithshëm. Domethënë, me përjashtim të Agim Çekut, Hashim
4 Thaçit, Kadri Veselit dhe jush, kush ka qenë tjetër në atë
5 ambient, në atë takim, nëse ka pasur persona të tjerë?

6 PË. Kjo periudhë ka qenë konsolidimi dhe takimet që ka pas me
7 -- dhe me anëtarë të tjerë si Qeveri e Përkohshme, delegacioni
8 i cili është i Rambujesë dhe ka pas edhe njerëz të tjerë. Po
9 mu më kujtohet, kur une në bisedë e sipër kam kërku vetë që të
10 tërhiqem dhe kam propozu, "është mirë që të jetë Gjeneral
11 Çeku", për arsyet edhe të opinionit të brendshëm dhe të
12 jashtëm, si profesion -- oficer i karrierës edhe si me gradë
13 gjeneral.

14 PY. Kur e thatë këtë ka qenë në të njëjtën bisedë kur keni
15 takuar për herë të parë Agim Çekun?

16 PË. Po, [E pakuptueshme].

17 PY. Në bisedën e parë që keni pasur me Agim Çekun, kush ka
18 qenë tjetër i pranishëm bashkë me ju?

19 PË. Nuk më kujtohet. Kanë qenë edhe disa të tjerë besoj, por
20 nuk më kujtohet kush ka qenë.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të donim
22 të përdornim paragrafin 89 të Shënimit Përgatitor për t'i
23 rifreskuar kujtesën dëshmitarit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Z. HALLING: [Përkthim]

1 PY. Dëshmitar, ju keni thënë kështu:

2 "Pas miratimit të planit për operacionit, jeni takuar me
3 Agim Çekun, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin."

4 Ju këtu nuk keni përmendur ndonjë person tjetër. A është
5 e saktë, pra, që këta kanë qenë personat me të cilët e keni
6 bërë këtë bisedë herën e parë kur jeni takuar me Agim Çekun?
7 PË. Është e saktë. Por, e ki edhe në kur jam taku me Agimin
8 paraprkisht në Operacionin Shigjeta, ta kam spjegu, edhe
9 oficerët e Shqipërisë të cilët kanë qenë z. Spiro Butka, ka
10 qenë edhe Shpëtim Golemi edhe në -- më duket një tjetër. I kam
11 spjegu që kanë punu në planin e Operacionit Shigjeta, me
12 planifikimin e operacionit, bashkë me ta dhe Agim Çeku.

13 PY. Kur thatë në bisedë që nuk donit të ishit më komandant i
14 përgjithshëm dhe mund të ishte Agim Çeku komandanti i
15 përgjithshëm si reagoi grupi ndaj kësaj?

16 PË. Me -- më kujtohet -- tash s'më kujtohet detajet më ka
17 thënë që jo, arsyeja pse presim edhe derisa të vjen edhe po më
18 duket delegacioni i -- njerëz të tjerë pritshin që të vijnë
19 edhe të nesërmen edhe -- por sa më kujtohet vetëm kjo ka qenë,
20 që unë dua të propozoj dhe mendoj se është më e mirë edhe për
21 UÇK-në edhe për mu që të jetë Agim Çeku. Këtë bisedë e kemi bo
22 bashkërisht në prani bashkë me -- në prezencë të të dyve, edhe
23 të Agim Çekut.

24 PY. Më falni, Dëshmitar, "të dyve" thatë, Agim Çeku dhe s'e
25 kuptuam pjesën tjetër të përgjigjes.

1 PË. Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, fjala ke për këta të
2 dëshmitar, palët.

3 PY. Në pjesën, atë pjesë të përgjigjes kur të thanë që të
4 tjerët do të vinin një ditë më pas, më vonë, kush ishin këta
5 të tjerët që do të vinin një ditë më vonë, nëse e di?

6 PË. Faktikisht të nesërmen ose të pasnesërmen e di se dy, tri
7 kemi qëndru aty në atë edhe ka ardhur Bislim Zyrapi, ka ardh
8 dhe Rexhep Selimi, Fatmir Limaj, po më duket dhe ai.

9 PY. Dëshmitar, pasi nënshkruat Operacionin Shigjeta, a
10 qëndruat ju për të qenë pjesë e diskutimeve më të gjera për
11 krijimin e këtij operacioni? A ishit ende pjesë e diskutimeve
12 për këtë operacion?

13 PË. Jo, nuk kam qenë, nuk kam qenë mo pjesë e diskutimeve.
14 Jam kthi për Drenicë prapë.

15 PY. Pasi u larguat, a mësuat ju ndonjë moment që nuk ishit më
16 komandant i përgjithshëm?

17 PË. Kjo ka ndodh mbas -- nuk e di këtë periudhën [E
18 pakuptueshme] me një grup si më ka shoqëru edhe po bashkë me
19 mu ka qenë edhe bashkëshortja ime në këtë kohë edhe jemi kthi
20 për Drenicë. Më kujtohet kam pa për në media ka dalë që Agim
21 Çeku a emëru komandant i -- shef i shtabit ose komandant i
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe njëkohësisht edhe emri im
23 si komandant garde.

24 PY. Pra, ju keni mësuar nga media se ka pas ndryshim të
25 Shtabit të Përgjithshëm, kështu? Të komandës së përgjithshme?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 139

1 PË. Po, se ato veç i kemi pas bisedë edhe për mes mediave kam

2 -- është komentu emërimi i Gjeneral Çekut dhe emërimi jem.

3 PY. Faleminderit. Dëshmitar, tani do diskutojmë disa çështje

4 të tjera me ju.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Për temën e parë do ju kërkoja, të

6 nderuar Gjykatës, që të kalojmë në seancë private në mënyrë të

7 tillë që të mbrojmë një palë të tretë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë

9 në seancë private për mbrojtjen e një pale të tretë.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 140

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 141

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Trupin Gjykues, jemi në
2 seancë publike.

3 Z. HALLING: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, teni që kemi kaluar në seancë publike përsëri,
5 pyetja që kam për ju është kjo: A jeni munduar që të
6 konfrontoheni ose të përballeni me personat në njësitin e
7 Sabit Gecit lidhur me atë çfarë ju thanë juve që i kishte
8 ndodhur personit numër 1?

9 PË. Jo të konfrontohem, por kam lyp sqarime edhe kam thënë që
10 kam bisedu për këtë çështje me personin

11 PY. A ke folur vetë ti me Sabit Gecin lidhur me këtë?

12 PË. Po.

13 PY. Me kë keni folur realisht ose ekzaktësisht? Keni folur
14 vetëm me të apo keni folur dhe me të tjerë?

15 PË. Faktikisht kam fol vetëm me Sabitin dhe për këtë person.
16 Domethënë për ankesën për personin numër 1.

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Të nderuar Gjykatës, do ju kërkoja që të kalonim përsëri
19 në paragrafin 76 të shënimit përgatitor që të sqaroj një
20 papajtueshmëri.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
22 vazhdoni.

23 Z. HALLING: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, në seancën përgatitore keni thënë që:

25 "Në qershor të '98-s keni shkuar për të pyetur grupin e

1 Sabit Gecit në qoftë se kanë qenë përgjegjës për atë çfarë
2 kishte ndodhur dhe jeni përpjekur që t'i thoni atyre që ata
3 nuk mund të qëndronin në zonën e Drenicës. Sabit Geci nuk
4 ishte aty, ishte në Shqipëri, por personat me të cilët keni
5 folur kanë qenë Sabit Haxha dhe Ismet Geci."

6 Me kë keni folur, edhe një herë është pyetja për ju? Me
7 kë keni folur, me keni folur vetë me Sabit Gecin, apo keni
8 folur me persona të tjerë?

9 PË. Mund të jetë gabim, unë thashë kam thon që kam fol me
10 Sabit Gecin dhe ma vonë ka shku për Shqipëri. Por, në qoftë se
11 e shiqoni edhe një herë ato ka qenë -- nuk e di a ka qenë edhe
12 Ismet Haxha, por kështu ka qenë.

13 Është hera -- hera e dytë ose e tretë që nuk po jemi të
14 kjartë atë si e kemi spjegu që jam mundu ta spjegoj. S'di a ka
15 qenë edhe kështu.

16 PY. Dhe për këtë arsye ndonjëherë është e rëndësishme që të
17 diskutohet ndonjë -- prapë duke pasur parasysh kontekstin.

18 Kur e diskutuat me Sabit Gecin dhe ngritët shqetësimin
19 ose rastin sipas asaj që ju tregua ju prej personit 1, çfarë
20 përgjigje dhatë juve?

21 PË. Çfarë përgjigje?

22 PËRKTHYESJA: Çfarë përgjigje morët ju prej tij?

23 DËSHMITARI: Unë në atë -- unë e kam spjegu që ata janë
24 thirr në emër të SHK-ut në këtë kohë dhe ata persona të cilët
25 janë kon me ta, një ose dy, nuk e di, Ismet Haxha e di që ka

1 qenë me ta, edhe është thirr në emër të SHIK-ut. Këtë e kam
2 spjegu edhe në herën e parë dhe të [E padëgjueshme], gjatë
3 procesit të personit 1, si dëshmi në --

4 PY. Në këtë bisedë a u tha gjithashtu se në emër të kujt po
5 bënin ato çfarë kishin bërë, sa i takon SHK-ut? Domethënë në
6 emër të kujt i kishin bërë ato veprime?

7 PË. Nuk tha në emër të kujt, por tha janë thirr në emër të
8 SHIK-ut, gjë që ma vonë besoj që nuk ka qenë e vërtetë.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duhet të
10 kalojmë përsëri në të paragraf të seancës përgatitore në qoftë
11 se më lejoni.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
13 vazhdoni.

14 Z. HALLING: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, ju thatë se:

16 "Ata ju kanë thënë që ata ishin pjesë e një shërbimi
17 informativ që njihej ndryshe me emrin SHIK", që e përmendët
18 tani.

19 Megjithatë, seancën përgatitore t'i ke thënë që:

20 "Ata u prezantuan dhe thanë që veprojnë në emër të Kadri
21 Veselit."

22 A e kanë prezantuar veten ata që kanë vepruar në emër të
23 Kadri Veselit, Dëshmitar?

24 PË. Ata masi janë prezantu si SHIK edhe janë thirr në emër të
25 Kadri Veseliit, mirëpo nuk kanë tregua asnjë dokument, sapo u

1 spjegu, edhe në -- edhe kam lyp sqarime në këtë kohë.

2 PY. Njësia e informatave, e Sabit Gecit, a është larguar
3 menjëherë nga zona pasi biseduat ju me të?

4 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jam i
5 shqetësuar për përshkrimin që i jepet njësitet. Mendoj që
6 pyetja duhet të bëhet në mënyrë të hapur, domethënë, çfarë
7 natyre ka pasur njësiti, dhe nuk duhet të bëhet në mënyrë të
8 tillë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
10 thoni që është sugjestionuese si pyetje pranohet kundërshtimi.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. HALLING: [Përkthim]

13 PY. Tani, Dëshmitar, ky grupi i personave që e quanin veten
14 SHIK, u larguan prej zonës pasi ju e bëtë bisedën që na e
15 shpjeguat pak më përpara me të?

16 PË. Sabit Geci ka qenë në trajtimin e mjekëve edhe herë pas
17 here ka lëviz në vendet, lokacione të ndryshme edhe ma vonë
18 është largu për -- është shku për Shqipëri për trajtim. Kurse
19 Ismet Haxhën në Zonën Operative të Shalës.

20 PY. U la për një fazë të mëvonshme. E kuptoj. Ne kemi
21 diskutuar bashkë, pra kemi diskutuar në seancën private një
22 artikull të Botës Sot. A jeni përfshirë në një përgjigje ndaj
23 këtij artikulli, Dëshmitar?

24 PË. Nuk e di sa më kujtohet, nuk e di a jam përfshirë në
25 artikull.

1 PY. A ka pasur ndonjë kundërtikull ndaj artikullit që është
2 botuar në Botën sot që e diskutuam në seancë private?

3 PË. Nuk e -- s'po më kujtohet saktë, po besoj që po. Nuk po
4 më -- nuk e -- s'po më kujtohet.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshirojmë që
6 të kalojmë në një prej deklaratave të mëparshme që janë
7 pranuar në prova gjyqësore të dhëna nga dëshmitari. Sa për t'i
8 rifreskuar memorien dëshmitarit. Për këtë duam që të shkojmë
9 në dokumentin SITF00031870 deri në 00031871. Këto janë faqet
10 konkrete, faqja e parë është 00031869.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
12 vazhdoni.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj që do na ndihmonte në qoftë
14 se Asistentja, Sekretarja e seancës do t'i paraqiste në ekran
15 këto dy faqe për ta bërë sa më e qartë që të jetë e mundur
16 pyetjen për dëshmitarin. Të kalojmë në fund të faqes, që është
17 faqja 31870.

18 PY. Këtu thuhet:

19 "Gjatë luftës ka pasur një urdhër nga Shtabi i
20 Përgjithshëm që Gani Geci ka qenë drejtuesi i ofensivës. Ka
21 pasur dhe një artikull kundërshtues që e mohonte këtë dhe i
22 kam thënë Ganiut që unë e kam bërë atë për të. Unë kam shkruar
23 një artikull kundërshtues të botuar në Botën Sot, dhe Gania
24 kishte marrëdhënie të mira ose njihte dikën në gazetë. Unë nuk
25 e mendoja që ai ishte personi që e kishte shkruar artikullin

1 pasi ne kishim qenë gjithmonë bashkë gjatë të gjithë kohës.”

2 Atëherë, artikulli kundërshtues që donit të shkruanit ju
3 në Botën Sot, a ka pasur të bënte ky artikull me personin 1,
4 Dëshmitar?

5 PË. Po, besoj që po.

6 PY. Pse dëshironit ju që të bënit ju një kundërartikull?

7 PË. Për arsye se ishte artikull të -- jo i saktë. Nuk e
8 përshkruante gjendjen reale.

9 PY. Pra, në artikullin kundërshtues, ju dëshironit që të
10 tregonit të vërtetën lidhur me atë çfarë kishte ndodhur. A
11 është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Atë ç'ka unë thashë këtu, edhe -- edhe -- edhe atë të
13 cilën me -- që nuk kisha të bëj me të.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të kalojmë në provën P185 në
15 shqip dhe në anglisht. Në faqen e parë të të dy dokumenteve me
16 numër SPOE00227659.

17 PË. Dëshmitar, ky nuk është një dokument që e kemi treguar
18 gjatë seancës përgatitore por dua t'ja u tregoj tani dhe do
19 t'ju bëj disa pyetje lidhur me të. Besoj që mund ta shikoni në
20 ekran tani. Është një dokument që fillon me sqarim dhe thuhet
21 që:

22 “E kam përmendur edhe më përpara që Sabit Geci ka marrë
23 urdhra nga Shtabi i Përgjithshëm, jo prej meje, në kohën kur
24 kam qenë shef i Zonës Operative të Drenicë, ai ka qenë shef i
25 Shërbimit Informativ të UÇK-së.”

1 Në fund të këtij -- të kësaj faqeje është emri juaj. A
2 është ky artikulli kundërshtues i botuar në Botën Sot,
3 Dëshmitar?

4 PË. Besoj që po.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Tani të kalojmë tek
6 një temë tjetër që ka të bëjë me policinë ushtarake. Do
7 fillojmë me provën P119 në shqip dhe në anglisht.

8 PY. Dëshmitar, juve ju kanë bërë pyetje në TPNJ lidhur me
9 këtë dokument. I keni thënë Trupit Gjykues në TPNJ, që këtë
10 dokument e ka nënshkruar Shaban Shala në emrin tuaj. A është e
11 saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, e saktë.

13 PY. Policia ushtarake e Drenicës a i filloi të kryente
14 veprimtaritë e veta në maj '98-s?

15 PË. Nuk jam i sigurt, por parapërgatitjet ose gjithmonë flas
16 në periudha të caktume nuk e di, a ka qenë e saktë kjo apo jo,
17 por ky dokument është nënshkru nga Shaban Shala edhe atëherë e
18 kam thonë edhe tash s'e di saktë.

19 PY. Dëshmitar, çfarë po thoni - po thoni që e dini që kjo nuk
20 është vërtetë, apo keni një arsye për të kundërshtuar
21 vërtetësinë e përmbajtjes?

22 PË. E para, thashë që nuk është i shkrum nga unë, është nga
23 Shaban Shala.

24 E dyta, nuk e di kohën e saktë, domethënë, 13 maj që
25 policia ushtarake ka qenë formume në këtë kohë. Po mendoj që

1 ka fillu në këtë periudhë që të formohet në kuadër të zonës.

2 PY. E kuptoj. Dëshmitar, a keni qenë i përfshirë ju në

3 luftimet e UÇK-së në Grykën e Llapushtikut -- Llap --

4 Llapashni -- Llapushnikut, më falni.

5 PË. Të Llapushnikut. Po, kam qenë i përfshirë në shumë

6 akcione, duke përfshirë dhe Llapushnikun.

7 PY. Të përqendrohemi vetëm në kohën kur keni luftuar në

8 Grykën e Llapushnikut. Kur në '98-n keni luftuar ju atje? Në

9 ça kohe, në ça periudhe?

10 PË. Kur ka qenë ofensiva e parë, nuk e di saktë cila datë,

11 por mund të keni datën ju, edhe besoj që e kemi dit, po e dimë

12 për kur po flas, por nuk më kujtohet data.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se

14 do të më lejoni dua t'i referohem paragrafit 86 të Shënimit

15 Përgatitor 2, për rifreskimit të memories së dëshmitarit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

17 vazhdoni.

18 Z. HALLING: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, kjo është ajo çfarë ju kujtua juve përpara një

20 jave sa i takon datave. Doni të sqaroni diçka para se të

21 vazhdojmë me pyetjen, Dëshmitar?

22 PË. Jo, jo, vetëm datën s'po më kujtohet, prandaj.

23 PY. Ajo çfarë na thatë në seancë përgatitore është që ju keni

24 marrë pjesë në luftimet në Grykën e Llapushnikut në vitin 1998

25 dhe thatë që nuk ju kujtohet në qoftë se keni luftuar një herë

1 ose dy herë gjatë majit. Dhe thatë që nuk keni njohuri për
2 beteja të tjera të ndodhura në atë vend. A është informacion i
3 saktë ky, Dëshmitar?

4 PË. Saktë. Unë kam marrë pjesë ma pak se -- domethënë, jo
5 vetëm një herë po kam marrë pjesët në luftimet personalisht në
6 Grykën e Llapushnikut, por vetëm thashë, nuk e di datën e
7 saktë.

8 PY. Po, por duket të paktën nga ça thatë juve, që të gjitha
9 luftimet kanë qenë diku nga maji i 1998-s, është e saktë kjo,
10 Dëshmitar?

11 PË. E saktë. Në qoftë se prej ditës së parë unë kam marrë
12 pjesë kur kanë hy forcat serbe në Llapushnik, unë kam marrë
13 pjesë personalisht në luftime.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është tema e fundit që do të
15 diskutojmë sot. Do i kërkoja Sekretares të paraqesë dhe një
16 herë në ekran provën P1745, konkretisht në faqen 60 -- 6D00072
17 në anglisht dhe SPOE00360476.

18 PY. Këtë e keni thënë si pjesë e intervistës me Zërin, që më
19 herët na thatë që ishte e saktë si intervistë. Do t'ju bëj një
20 pyetje tani përpara sesa ta mbyllim për sot.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Mendoj që duhet të jetë në faqen
22 13 në PDF në anglisht. Faleminderit.

23 PY. Pyetja që ju bëhet është kjo:

24 "Beteja për Grykën e Llapushnikut paraqet një prej
25 momenteve më të rëndësishme të luftës. Cili ishte kontributi i

1 zonës suaj në këtë betejë?”

2 Ju thoni si pjesë e këtij shpjegimi që:

3 “Njësitë e tjera, komandantët dhe luftuesit e tjerë si
4 Fehmi Lladrovci, Rasim Kaçina [Sipas përkthimit] dhe policia
5 ushtarake e drejtuar nga Sahit Jashari dhe shumë persona të
6 tjerë që kanë pjesë në luftimet e Grykës së Llapushnikut.”

7 Atëherë, a nuk i keni thënë ju këtë informacion Zërit,
8 Dëshmitar? Pra, që policia ushtarake e Sahit Jasharit ka qenë
9 aktive që prej majit të '98-s. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
10 PË. Mund të jetë e saktë. Unë e di që edhe Sahit Jashari ka
11 marrë pjesë në këto luftime. Në këtë periudhë, a ka qenë, sa
12 ka qenë e zhvillume policia ushtarake nuk mund të them, po e
13 di që të gjithë këta që kam përmend kanë qenë në këto luftime
14 bashkë, edhe unë kam marrë pjesë me ta. E di që edhe Sahit
15 Jashari edhe shumë të tjerë kanë marrë pjesë në këtë.

16 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Do vazhdojmë nesër.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
18 përfunduar me dëshminë tuaj sot. Tani mund të largoheni. Do
19 fillojmë përsëri nesër në orën 9.00 të mëngjesit. Ju lutem mos
20 flisni me askënd lidhur me dëshminë tuaj, me askënd jashtë
21 sallës së gjyqit. Faleminderit që ishit me ne sot.

22 Faleminderit, z. Kërpini dhe juve. Faleminderit që ishit
23 me ne, z. Qerkini.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thuajse se

1 keni përdorur katër orë. A mund të na thoni çfarë planifikoni
2 për nesër?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Do përfundojmë në seancën e parë
4 nesër.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
6 Përfunduar sot këtu.

7 Do takohemi përsëri nesër në orën 9.00

8 --- Seanca mbyllet në orën 16.32

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25